

**RAPORT**  
**I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK**

**Për Programin e studimit “Bachelor” në “Mësuesi për Arsimin Fillor”**

**Universiteti Privat “Albanian University”**

**Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:**

**Dr. Dilina Beshiri**



**Dr. Leticja Gusho**



Korrik, 2019

**RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**  
**Për Programin e studimit “Bachelor” në “Mësuesi për Arsimin Fillor”**

	Tabela e të dhënave për programin e studimit	
1	IAL Aplikues:	Universiteti Privat “Albanian University”
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Shkencave Shoqërore/ Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	UMASH Nr. 251, datë 02.06.2011
4	Urdhëri/VKA e Akreditimit të parë	VBA Nr. 34, datë 19.05.2017
5	Titulli i programit të studimit:	Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor”
6	Cikli i studimit:	Cikli i parë
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike
8	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
11	Programi ofrohet nga institucioni	Po
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	Jo
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	Jo
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	Jo
15	Niveli në Kornizën Kombëtare të kualifikimeve	Niveli 6
16	Aktivizimi i programit të studimit	Viti akademik 2010-2011
17	Numri i studentëve	110 studentë

## HYRJE

Në kuadrin e akreditimit periodik të programit të studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor”, të kërkuar nga Universiteti Privat “Albanian University”, është realizuar dhe procesi respektiv i vlerësimit. Në këtë raport janë pasqyruar gjetjet që kanë dalë si rezultat i analizës për procesin e vlerësimit të jashtëm.

Institucioni jopublik i arsimit të lartë “Albanian University” është vazhdues i universitetit UFO (UFO University), i themeluar me vendimin nr.197, datë 10.04.2004 të KM dhe riorganizuar me Vendimin nr. 603, datë 24.03.2011 të KM. Përgjatë viteve ky institucion i arsimit të lartë ka pësuar një sërë ndryshimesh si në emërtim ashtu edhe në strukturën e tij.

Me Urdhër të Ministrisë të Arsimit dhe Sportit nr.596, datë 21.12.2016 është miratuar Statuti dhe Organigrama e Re në përputhje me Ligjin 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” (sipas Vendimit të Senatit Akademik nr.203, datë 28.09.2016 të Universitetit).

Gjithashtu, “Albanian University” ka kaluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit, proces i zhvilluar nga ASCAL në bashkëpunim me Agjencinë Britanike të sigurimit të cilësisë QAA. Ky vlerësim u finalizua me Vendim të Bordit të Akreditimit nr.90, datë 20.10.2017 dhe Universiteti është akredituar me kohëzgjatjen 2 vite, me afat vlefshmërie deri në 19.10.2019. Aktualisht, “Albanian University” është në proces vlerësimi në kuadër të akreditimit periodik institucional.

Universiteti “Albanian University” përbëhet nga tre fakultete:

- **Fakulteti i Shkencave Mjekësore,**
- **Fakulteti i Shkencave Shoqërore, si edhe**
- **Fakulteti i Shkencave të Aplikuara.**

**Fakulteti i Shkencave Mjekësore** ka tre departamente: *Departamenti i Stomatologjisë, Departamenti i Farmacisë, si edhe Departamenti i Infermierisë dhe i Fizioterapisë.*

**Fakulteti i Shkencave Shoqërore** funksionon me katër departamente: *Departamenti i Shkencave Juridike, Departamenti i Shkencave Politiko-Administrative, Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme, si edhe Departamenti i Edukimit dhe i Anglishtes.*

**Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike,** ka tre departamente: *Departamenti i Shkencave Ekonomike, Departamenti i Arkitekturës, si edhe Departamenti i Inxhinierisë.*

Ky universitet publikon revistën shkencore “Optime”.

Universiteti “Albanian University” në përputhje me Ligjin nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”, ofron studime me kohë të plotë në tre ciklet e studimit: Bachelor, Master (Master Profesional dhe Master shkencor), si edhe doktoraturë e specializime afatgjata.

Objekti i këtij vlerësimi të jashtëm është programi i studimit me kohë të plotë i ciklit të parë Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor” i ofruar nga Departamenti i Edukimit dhe i Anglishtes. Ky departament ka filluar funksionimin e tij në vitin 2010, në UFO University, emëruar më pas Universiteti Privat “Albanian University”, si pjesë përbërëse e Fakultetit të Shkencave Shoqërore. Departamenti i Edukimit dhe i Anglishtes ofron tre programe studimi Bachelor në: “Mësuesi për Arsimin Fillor”, program i studimit i ciklit të parë, i licencuar me Urdhër të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës nr. 251 datë 02.06.2011, “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” dhe “Anglisht”. Gjithashtu, ky departament ofron një program studimi “Master Profesional në “Pedagogji” me dy profile: Profili i parë “Didaktikë” dhe profili i dytë “Menaxhim Arsimi”. Të gjitha programet e studimit që ofron ky departament, si të ciklit të parë ashtu dhe të ciklit të dytë, janë të akredituara. Stafi akademik dhe Institucioni angazhohen në përmbushjen e detyrimeve ligjore të rrjedhura nga akreditimi i programeve të studimit që ofron ky departament.

Programi i studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor” është hapur njëkohësisht në selinë qendrore në Tiranë dhe në Filialin e Beratit në 2011, ndërsa prej vitit 2014-2015 kur u mbyll Filiali i Beratit, ky program studimi ofrohet vetëm në Tiranë.

Numri i studentëve të regjistruar për herë të parë në vitin 2011–2012 ka qënë 78, ndërsa në vitin 2015-2016 janë regjistruar 116 studentë nga të cilët 71 të transferuar nga Filiali Berat dhe 45 studentë të regjistruar për herë të parë. Për vitin akademik 2017-2018 janë regjistruar 53 studentë nga të cilët 15 transferime dhe 38 të regjistruar për herë të parë. Aktualisht, për vitin akademik 2018-2019 numri i studentëve të regjistruar është 16, nga të cilët 2 transferime dhe 14 të regjistruar për herë të parë.

#### **Metodologjia për realizmin e vlerësimit të jashtëm**

Qëllimi kryesor i procesit të vlerësimit të jashtëm ka qënë identifikimi i nivelit të përmbushjes së standardeve shtetërore të cilësisë për arsimin e lartë, për programin e studimit të ciklit të parë Bachelor.

Ky vlerësim është realizuar për programin Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor”.

#### Dokumentacioni ligjor mbi të cilin është mbështetur procesi i vlerësimit të jashtëm

Baza ligjore mbi të cilën është mbështetur vlerësimi i jashtëm është:

- Ligji nr.80 dt 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.197, datë 10.04.2004 për dhënien e licencës Institucionit të Arsimit të Lartë Jopublik “UFO University” dhe riorganizuar me Vendimin nr.603, datë 24.03.2011 të KM, si “Albanian University”
- Urdhëri i Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës (Sot Ministria e Arsimit dhe Sporteve), për licensimin e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor “Mësuesi në Arsimin Fillor” nr.251, datë 02.06.2011
- Rregullore e sigurimit të cilësisë e ASCAL

#### Aktivitet kryesorë të realizuara

Në kuadër të këtij vlerësimi janë kryer disa aktivitete. Për këtë funksion është realizuar analiza e të dhënave parësore, analiza e të dhënave dytësore, si edhe vëzhgimet në terren.

- *Analiza e të dhënave parësore.* Të dhënat parësore janë ekstraktuar nga raporti i vlerësimit të brëndshëm për programin e studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor” (Maj 2019) i realizuar nga grupi i vlerësimit të brëndshëm (GVB), (shkresë nr.211 Prot, datë 27.03.2019) nga statuti i AU i riorganizuar sipas Ligjit nr.80/2015, Rregullore e Fakultetit të Shkencave Shoqërore, paketa/dosja e plotë e dokumentacionit të Programit, programet lëndore, si dhe dokumentacione të tjera administrative (siç është dokumentacioni i personelit).
- *Analiza e të dhënave dytësore.* Analiza e të dhënave dytësore u mbështet në të dhënat e marra nga vizita dy ditore në institucion. Vizitat në ambjentet e institucionit të “AU” u zhvilluan në datat 12 dhe 19 Qershor 2019. Gjatë këtyre vizitave u zhvilluan disa intervista dhe vëzhgime. Kështu, u realizuan intervista me drejtuesit e Njësive, Zv/Rektoren për procesin mësimor (në mungesë të Dekanit të Fakultetit të Shkencave Shoqërore), Përgjegjësën e Departamentit të Edukimit dhe Anglishtes, Takim me përfaqësues të Njësive të Sigurimit të Brëndshëm të Cilësisë dhe Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave, Takim me përfaqësues të Zyrës së Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentit dhe Zyrën Alumni, Takim me përfaqësues të Zyrës së Koordinimit të Kërkimit Shkencor dhe Botimeve Akademike, Takim me përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore, Takim me përfaqësues të Grupit të vetëvlerësimit të programit, Takim me stafin akademik të programit të studimit, Takim dhe intervista me studentët.
- *Vëzhgimi i mjediseve.* Gjatë ditëve të vizitave në institucion u realizuan vëzhgime të auditorëve, të laboratorëve të informatikës, kimisë, biologjisë, ambjenteve të bibliotekës, zyrave, etj.

Duke u mbështetur mbi analizën e të dhënave të marra nga këto burime është hartuar dhe raporti i vlerësimit të jashtëm (RVJ).

Parimet bazë mbi të cilat është mbështetur procesi i vlerësimit të jashtëm

Grupi i punës për vlerësimin e jashtëm për realizimin e procesit të vlerësimit është mbështetur në disa parime bazë, të cilat janë:

- *Besueshmëria.* Të gjitha gjetjet e paraqitura në këtë raport përmbushin faktin e besueshmërisë pasi ato janë të gjitha të bazuara në indikatorë dhe në të dhëna të besueshme.
- *Integriteti.* Të dy vlerësuesit përgjegjës për hartimin e këtij raporti garantojnë ndershmërinë e të gjithë procesit të vlerësimit, mbështetur mbi qëndrueshmërinë e veprimeve si edhe në bazë të të gjithë metodologjisë së përdorur për mbledhjen e të dhënave.
- *Pavarësia.* Gjatë gjithë procesit të vlerësimit janë patur parasysh dy faktorë të rëndësishëm. Faktori i parë ka të bëjë me shmangien e konfliktit të interesit, ku të dy vlerësuesit nuk kanë ndonjë konflikt interesi me institucionin në fjalë, si edhe pavarësia e gjykimit. Ky indikator garanton që gjatë gjithë procesit, gjatë analizës së dokumentacionit, si edhe gjatë mbledhjes së të dhënave në institucion dhe nxjerrjes së konkluzioneve përfundimtare, vlerësuesit kanë shprehur pavarësi të plotë gjykimi dhe vlerësimi dhe nuk kanë qënë në ndonjë lloj forme presioni nga palë të tjera.
- *Kompetenca.* Ekspertët e përfshirë në këtë proces kanë një përvojë të gjatë pune në Institucionet e Arsimit të Lartë, kanë përvoja edukimi në institucione perëndimore, si edhe zotërojnë të gjithë ekspertizën e duhur që të garantojnë një proces dhe një produkt vlerësimi në cilësinë e kërkuar.
- *Paanësia.* Në të gjithë treguesit e paraqitur në raportin e vlerësimit të jashtëm ka një ekuilibër të qartë midis paraqitjes së të gjithë indikatorëve. Për më tepër, për të gjithë elementët e marrë në shqyrtim gjatë procesit të vlerësimit janë paraqitur pikat e forta dhe pikat e dobëta. Në të gjithë procesin e vlerësimit paanësia ka qënë një nga elementët më të rëndësishëm të tij.

**GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)**

Përbërja e GVJ: Bordi i Akreditimit dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, vendosën: Dr. Dilina Beshiri dhe Dr. Leticja Gusho si ekspertë të jashtëm vlerësimi për këtë program studimi. Gjatë gjithë procedurës, ekspertët e jashtëm të vlerësimit janë asistuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL: Znj. Emisa Isufaj dhe gjatë vizitës në institucion nga Znj. Majlinda Demirneli.

Universiteti Privat “Albanian University” është njohur me Draft – Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 23.07.2019, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 128/22 Prot., datë 23.07.2019. UP “Albanian University” përcjell në ASCAL nëpërmjet shkresës me Nr. 416 Prot., datë 30/07/19 komentet në lidhje me Draft – Raportin e Vlerësimit të Jashtëm. Ekspertët e Vlerësimit u njohën me komentet dhe vendosën të japin argumentat e mëposhtme dhe të bëjnë një reflektim si më poshtë:

- 1) **Konstatim i GVJ:** Analizë për plotësimin e rekomandimeve të dhëna nga BA në vendimin për akreditim, Pika I, “Misioni/Objektivat e programit të studimit” Konkluzione fq.8: “Për një mbarë vajtje më të mirë të programit të studimit, GVJ sugjeron një studim më të detajuar të tregut të punës, i pajisur edhe me metodologjinë dhe instrumentat e duhura për mbledhjen e të dhënave, për të hulumtuar në mënyrë të plotë nevojat dhe mundësinë e punësimit të studentëve....”

**Komenti i IAL:** Programi i studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor” që nga koha e hapjes së tij dhe aktualisht ka qënë i suksesshëm përsa i përket numrit të studentëve të regjistruar ndër vite si dhe ecurisë së tij. Analiza e tregut të punës është bazuar në të dhëna konkrete mbi nevojat që ka tregu i punës në vendin tonë për Mësues të Arsimit Fillor. Përsa i përket mundësisë së punësimit të studentëve për këtë program studimi, sipas legjislacionit në fuqi, studentët duhet të kryejnë edhe ciklin e dytë të studimeve si dhe provimin e licencimit për tu përshtatur në tregun e

punës. Departamenti në bashkëpunim edhe me QSHA-në disponon një bazë të dhënash në të cilat specifikohen se sa prej studentëve kanë kaluar me sukses provimin e licencimit.

**Përgjigjja GVJ:**

**GVJ vlerëson përpjekjet e institucionit dhe e inkurajon më tej për një studim të detajuar të tregut të punës, mbështetur në metodologji shkencore dhe instrumeta matës për të hulumtuar e realizuar një analizë të plotë mbi nevojat dhe mundësitë e punësimit të studentëve në nivel rajonal, kombëtar, si edhe më gjërë, të evidentuara nga GVJ në Draft Raport.**

- 2) **Konstatim i GVJ:** Analizë për plotësimin e rekomandimeve të dhëna nga BA në vendimin për akreditim, Pika IV, "Infrastruktura në funksion të programeve të studimit, logjistika, si dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit" Konkluzione fq.18: "Sugjerohet pasurimi i mëtejshëm i fondit hardcopy të titujve të bibliotekës në funksion të këtij programi studimi, akomodimi i sallës së leximit të studentëve në një mjedis me dritë natyrale si dhe ngritja e instrumenteve matës për numrin e studentëve dhe lektorëve që frekuentojnë bibliotekën online "Questia".

**Koment i IAL:** Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes pasuron vazhdimisht bibliotekën me tituj të rinj tekstesh në funksion të programit të studimit. Çdo fillim viti akademik Departamenti harton një listë librash me një fond përkatës të cilat u vijnë në ndihmë studentëve që studiojnë në programet që ky Departament ofron. AU përveç bibliotekës në godinën qendrore ofron edhe 2 biblioteka në godinat e tjera, në të cilat gjenden tituj të ndryshëm në funksion të programit të studimit Bsc. 'Mësuesi për Arsimin Fillor' dhe mund të frekuentohen nga studentët. Albanian University prej vitesh përdor bibliotekën online "Questia" mbi bazën e një abonimi të pëvitätshëm. Si përdorues të "Questia" nuk ofrohet akses për shikimin e klikimeve në këtë bibliotekë.

**Përgjigjja GVJ:**

**GVJ vlerëson përpjekjet e institucionit për të pasuruar çdo semestër fondin e literaturës në shërbim të Departamentit të Anglishtes dhe Edukimit, por numri i titujve i vënë në dispozicion për programin e studimit Bachelor "Mësuesi për Arsimin Fillor", evidentuar nga GVJ në Draft Raport është i reduktuar. Pavarësisht mundësisive që studentët kanë për të frekuentuar mjediset e bibliotekave të cilat ndodhen në godina të ndryshme të AU, rezulton se studentët e këtij program studimi janë të regjistruar dhe frekuentojnë bibliotekën në godinën qendrore, ku zhvillojnë edhe procesin mësimor. Për këtë arsye, GVJ i qëndron mendimit të shprehur në Draft Raport.**

- 3) **Konstatim i GVJ:** Analizë për plotësimin e rekomandimeve të dhëna nga BA në vendimin për akreditim, Pika V, "Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare" Konkluzione fq.19: "Nuk konstatoam të ketë një buxhet qoftë edhe modest për grantet kërkimore-shkencore dhe shërbime trajnuese".

**Koment i IAL:** "Albanian University" në mbështetje të Ligjit 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" harton dhe miraton çdo vit kalendarik projekt buxhetin, mbi bazën e propozimeve të njësive kryesore dhe të njësive bazë. "Albanian University" për Departamentin e Edukimit dhe Anglishtes ka miratuar në mënyrë të vazhdueshme një buxhet, i përcaktuar për kërkimin shkencor, mbi bazën e të cilit, financohen të gjitha aktivitetet kërkimore shkencore. Norma e financimit të kërkimit shkencor të përcaktuar në buxhet është 2000 Lekë/student. Bordi i Administrimit shqyrton edhe kërkesa të tjera të njësive, kur norma e përcaktuar ezaurohet. Personeli akademik bën kërkesë te Administratori i Përgjithshëm dhe Rektori i Universitetit, të cilët shqyrtojnë çdo rast dhe marrin vendimin përkatës. Bashkëngjitur, gjeni projekt buxhetin për vitin kalendarik 2018 dhe vitin kalendarik 2019 dhe një praktikë të financimit për pjesëmarrje në Konferencën e Tretë Ndërkombëtare Shkencore

“Education, Heritage and Cultural Studies” të pedagoges së Departamentit të Edukimit dhe Aglishtes Dr. Desara Agaj. (Evidencë nr. 1)

AU organizon çdo fillim viti akademik trajnime për stafin akademik dhe administrativ, me ekspertë të certifikuar.

**Përgjigja GVJ:**

**GVJ vlerëson përpjekjet e institucionit për financimin e stafit akademik për pjesëmarrje në konferenca shkencore si dhe trajnime të ndryshme profesionale, por i qëndron argumentit se institucioni nuk ka një politikë të qartë për përthithjen e granteve për kërkimin shkencor.**

- 4) **Konstatim i GVJ:** Analizë për plotësimin e rekomandimeve të dhëna nga KA në vendimin për akreditim, Pika VII, “Programi i studimit, organizimi i tij” Konkluzione fq.25: Sugjerojmë riorganizim të plan programit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor” në masën 20 % duke u bazuar në “Standardet e formimit të përgjithshëm të mësuesit fillor” publikuar nga IZHA (sot ASCAP) (2016) dhe në respektim të VKM nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL”, për kategorizimin e saktë të veprimtarive formuese për programin Bachelor.

**Koment i IAL:** Programi i studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor” është një program i konsoliduar i cili ofron një kurrikul bashkëkohore dhe gjithëpërfshirëse. Në vitin akademik 2017-2018 ky program studimi është riorganizuar me qëllim përmirësimin e tij dhe përshtatjen më së miri me tregun e punës, në përputhje me VKM nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL”, si dhe me “Standardet e formimit të përgjithshëm të mësuesit fillor”.

- I. Grupi i punës i ngritur (Prof.Asoc. Sotir Rrapo, Dr. Ndriçim Mehmeti, Dr. Gilberta Hadaj, Dr. Hajri Mandri), për të punuar mbi ndryshimet në këtë program përbëhet nga njohës shumë të mirë të “Standardeve të formimit të përgjithshëm të mësuesit fillor” (IZHA 2016) si dhe ekspert të arsimit parauniversitar dhe universitar në Shqipëri.
- II. Ky grup ka bërë të mundur përfshirjen plotësisht të standardeve në këtë program studimi duke filluar nga trajtimi i lëndëve të tilla si Psikologji për fëmijët me nevoja të veçanta (Referohu Standardit nr. 3 Krijimi i një mjedisi gjithëpërfshirës), (Referohu Standardit nr. 4 “Pranimi dhe respektimi i diversitetit”..
- III. Lënda Metodologji e përgjithshme e mësimdhënies apo Psikologji zhvillimi për fëmijët e moshës 6-11 vjeç e cila përfshihet në kurrikulën e këtij programi na paraqet më së miri Standardin nr. 5 Përditësimi i metodologjive të mësimdhënies ku specifikohet: “Mësuesi i ciklit fillor e planifikon dhe e zhvillon mësimdhënien duke u bazuar në psikologjinë moshore të nxënësve, teoritë të të nxënësve, modelet e mësimdhënies dhe në kërkesat e kurrikulës zyrtare.....”
- IV. Disa prej këtyre standardeve siç është ai nr. 6 Njohja dhe zbatimi i metodave të vlerësimit apo Standardi nr. 1 Angazhimi i mësuesit në zhvillimin e tij profesional vihen në zbatim në kurrikulën e ciklit të dytë të studimeve Master Profesional të cilët këta student janë të detyruar për ta ndjekur (sipas legjisllacionit në fuqi) për tu formuar si Mësues të Arsimit Fillor.
- V. Pra i gjithë programi i studimit është i përshtatur në bazë të “Standardeve të formimit të përgjithshëm të mësuesit fillor” duke i shkruar më së mirë në përmbajtjen e tij në të gjitha disiplinat. Gjithashtu ky program studimi është në përputhje me kriteret e VKM nr. 41 datë 24.01.2018.

**Përgjigja GVJ:**

**GVJ vlerëson përpjekjet e institucionit dhe grupit të punës për rishikimin e plan programit për programin e studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor”, por inkurajon institucionin për një riorganizim të kurrikulës në masën 20%, duke respektuar të shtatë standartet për formimin e përgjithshëm të mësuesit fillor. GVJ i qëndron**

mendimit të shprehur në Draft Raport me argumentin se ndarja e kategorive të veprimtarive formuese nuk është në përputhje të plotë me VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL”. Lëndët plotësuese të kategorisë D si gjuhë e huaj, njohuri informatike janë pasqyruar në “Plani mësimor të ndarë në kategori formuese” si lëndë të kategorisë C (lënde ndërdisiplinore) duke cënuar raportin e % të kategorive formuese bazuar në VKM e sipërcituar. Për këtë arsye, GVJ i qëndron mendimit të shprehur në Draft Raport.

- 5) **Konstatim i GVJ:** Analizë për plotësimin e rekomandimeve të dhëna nga KA në vendimin për akreditim, Pika XI, “ Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar, si edhe marrëdhëniet me publikun” Konkluzione fq.32: Sugjerojmë, gjithashtu, të zgjerohet marrëveshja e bashkëpunimit me Albanian College, si institucion bazë pritës, mentorshipi, për realizimin e praktikave profesionale të këtij programi studimi.

**Komenti i IAL:** Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes i kushton një rëndësi të veçantë kryerjes së praktikës profesionale në këtë program studimi. Lektorët e praktikës profesionale zhvillojnë herë pas here aktivitete të ndryshme në kuadër të praktikës profesionale dhe në bashkëpunim edhe me institucionet ku studentët zhvillojnë praktikat. Konkretisht në bashkëpunim me Albanian College studentët e programit të studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor” kanë zhvilluar orë të hapura mësimore, me qëllim shkëmbimin e përvojave të stafit mësimdhënies internacional të Albanian College. (Bashkëngjitur fotot)

**Përgjigjja GVJ:**

GVJ vlerëson përpjekjet për realizimin e orëve mësimore të hapura pranë “Albanian College”, por inkurajon institucionin për realizimin e një aktmarrëveshje me këtë intitucion për zhvillimin e praktikës profesionale të studentëve të programit të studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor” pranë këtij institucioni.



## ADMINISTRIMI I NJËSISË NË SHËRBIM TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

### 1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

#### Pjesa përshkrimore

“Albanian University” ka një plan të zhvillimit të institucionit për vitet 2017-2022. “Albanian University” është përfaqësimi i një alternative serioze, të besueshme, profesionale, si edhe konkurruese, që synon të ofrojë standarde, cilësi, përgatitje bashkëkohore, përshtatje me tregun e punës vendas, si edhe më tej.

Sipas Planit Strategjik të Zhvillimit Institucional (2017-2022), misioni i “Albanian University” është të krijojë, të transmetojë, të zhvillojë dhe të mbrojë dijet me anë të mësimdhënies; të ofrojë programe të studimit në tre ciklet e studimit; të zhvillojë punë shkencore në të gjitha fushat që mbulon, si edhe të përgatisë specialistë dhe shkencëtarë të rinj; të realizojë kërkimin shkencor dhe veprimtari krijuese; të ofrojë mundësi për të përfituar nga arsimi i lartë gjatë gjithë jetës; të ndihmojë në zhvillimin ekonomik në një nivel kombëtar dhe rajonal; të kontribuojë në rritjen e standardeve të demokracisë e të qytetërimit të shoqërisë dhe në përgatitjen e të rinjve për një shoqëri bashkëkohore; të ofrojë shërbime në përputhje me misionin e tij; të mbështesë dhe të realizojë aftësimin e personelit akademik, duke i garantuar mundësi të barabartë për të përfituar nga financimet për kërkimin shkencor.

Sipas **Planit Strategjik të Zhvillimit Institucional, 2017-2022**, Objektivat Strategjike të “Albanian University”, në pesë vitet e ardhshme përqendrohen në drejtimet e mëposhtme:

1. Objektivat e Organizimit Institucional;
2. Mësimdhënia, Kurrikula, dhe e Nxëna me në qëndër formimin e studentëve;
3. Kërkimi Shkencor dhe Inovacioni;
4. Sigurimi i Brëndshëm i Cilësisë;
5. Veprimtaritë Shërbyese;
6. Marrëdhëniet me Jashtë;

Programi i studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor” ofrohet në përputhje të plotë me misionin, qëllimet dhe strategjinë për zhvillim 2017 -2022 të “Albanian University”. Ky program synon pajisjen e studentëve me njohuritë bazë të metodave bashkëkohore të mësimdhënies. Ky është një program studimi i ciklit të parë dhe është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe me zhvillimin ekonomik të vendit, si edhe nuk bie ndesh me interesat dhe vlerat kulturore kombëtare. Ky program studimi ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin e studentëve, të cilat përfshijnë dijet, aftësitë, si edhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të tij. Ky program studimi është i organizuar në module dhe është i vlerësuar në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ky program studimi është me kohë të plotë dhe sasia e krediteve të grumbulluara gjatë një viti akademik nga një student që ndjek këtë program është 60 kredite.

Objektivat e programit të studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor” janë përcaktuar sipas **Rregullores së Programit, Neni 4:**

- Ofrimi i njohurive të përgjithshme dhe specifike të programit, të mbështetura në lëndë të formimit bazë, plotësues dhe ndërdisiplinor.
- Përgatitja e ekspertëve të aftë për të operuar në fushën e edukimit, për të qënë të aftë të integrohen në mësimdhënie në shkolla apo institucione me karakter specifik në fushat përkatëse.

Qëllimi i kurrikulës për këtë program studimi, është që t’u ofrojë studentëve njohuri të cilat do të jenë të nevojshme për t’u integruar me tregun e punës, si mësues të ardhshëm dhe, në të njëjtën kohë, t’ju përgjigjet kërkesave me të cilat do të përballen studentët gjatë realizimit të tyre profesional.

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardet/kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>I - OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b>	
<b>Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</b>	
<p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p><b>Kriteri 6</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Programi studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor është hartuar në përputhje të plotë me misionin, qëllimet dhe planin strategjik të UP “Albanian University”. Ky program ofron studimet për mësues për ciklin fillor në një nga fushat e shkencave të edukimit, që ka një peshë të rëndësishme dhe në veprimtarinë e këtij institucioni. Ky program promovon vlera të ofruara nga ky institucion që synojnë të ruajnë vlerat kulturore dhe kombëtare.</p> <p>Programi në përbërjen e tij ka të përcaktuara objektivat të cilat synojnë ofrimin e njohurive të përgjithshme dhe specifike të mbështetura në lëndë të formimit bazë, plotësues dhe ndërdisiplinor, si edhe përgatitjen e ekspertëve të aftë për të operuar në fushën e edukimit, për të qënë të aftë të integrohen në mësimdhënie si në shkolla ashtu edhe në institucione me karakter specifik në fushat përkatëse.</p> <p>Ky program i përgjigjet kërkesës për mësues të arsimit fillor, që funksionon në një treg pune të mirëkonsoliduar dhe me përvojë, por si rezultat i dinamikave të reja të lëvizjes migruese dhe emigruese të popullsisë ka gjithmonë kërkesa të vazhdueshme, si nga institucionet publike ashtu edhe nga ato jopublike.</p> <p>Ky program studimi ka mbajtur parasysh zhvillimin ekonomik të viteve të fundit të vendit tonë, si një element i ndërlidhur ngushtësisht me faktorët socialë, edukativë dhe kulturorë. Duke qënë se “Albanian University” ka në përbërjen e tij edhe një Fakultet të Shkencave Shoqërore, ky program është një ndihmesë për dhënien e kontributit në këtë drejtim.</p>
<b>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë pajisjen me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë dhe formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale dhe specialitetesh në realizimin e misionit dhe qëllimit të institucionit;</p>	<p>Ky program studimi ka një përputhje të plotë me strategjinë e zhvillimit të institucionit. Ky element mund të shihet i inkorporuar në objektivat e programit për të formuar mësues si specialistë të mirëformuar.</p> <p>Nga analiza e syllabuseve të programit konstatohet një ndërthurje e elementëve akademikë me kompetencat profesionale të duhura për një mësues ndërsa programi ka të shprehura kombinimin e elementëve të kërkimit me ato të mësimdhënies.</p>
<b>II - ORGANIZIMI, DREJTIMI, SI EDHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b>	
<b>Standardi II.1 - Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili</p>	<p>Programi i studimit është hartuar pasi institucioni ka marrë një iniciativë për të studiuar nevojat e tregut të punës dhe për të realizuar një analizë mbi mundësinë e punësimit të studentëve në nivel rajonal, kombëtar, si edhe më gjërë. Kështu, nga dokumenti i analizës së nevojave të paraqitur nga institucioni rezulton se për dy vitet e fundit, në</p>

<p>përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar e ndërkombëtar;</li> <li>kërkesat e punëdhënësve;</li> <li>një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program;</li> <li>numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra.</li> </ol>	<p>programin Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor” nga numri i studentëve të diplomuar në përputhje me diplomën janë 15.</p> <p>Institucioni ka një pasqyrë të qartë të reflektuar dhe me dokumentacionin përkatës mbi numrin e studentëve të regjistruar në institucione të tjera të arsimit të lartë në vend, të cilat ofrojnë të njëjtën mundësi për t’u diplomuar si “Mësues i Ciklit fillor”.</p> <p>Institucioni nuk ka një parashikim të pritshëm të studentëve të cilët mund të regjistrohen për vitin akademik 2019-2020. Kjo e dhënë është dëshmuar nga takimet në institucion.</p>
<p><b>Standardi II.2 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe studimesh që nuk bien ndesh me interesat kombëtare;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Ky program studimi nuk bie ndesh me interesat kombëtare. Ky program synon të ndihmojë në ruajtjen e vlerave kombëtare duke përgatitur mësues të ciklit fillor që do të punojnë për këtë drejtim.</p> <p>Syllabuset lëndore pasqyrojnë vlerat kombëtare, bashkëveprimin e kulturës sonë me atë botërore, etj.</p> <p>Kjo konfirmohet nga RVB si edhe nga takimet e zhvilluara me pedagogët dhe studentët.</p>
<p><b>Konkluzionet e vlerësimit:</b></p> <p>Synimet dhe përmbajtja e programit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor” përputhen tërësisht me strategjinë e zhvillimit institucional të “Albanian University” dhe me ruajtjen e vlerave kulturore dhe me interesat kombëtare. Për një mbarëvajtje më të mirë të programit të studimit, GVJ sygjeron një studim më të detajuar të tregut të punës, i pajisur edhe me metodologjinë dhe instrumentat e duhura për mbledhjen e të dhënave, për të hulumtuar në mënyrë më të plotë nevojat dhe mundësinë e punësimit të studentëve, për më tepër duke depistuar në mënyrë më të plotë kërkesat e punëdhënësve, sidomos atyre të sektorit jopublik.</p>	

## 2. Struktura akademike e Fakultetit (përgjegjës për programin e studimit)

### Pjesa përshkrimore

Program i Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor” është nën kompetencën e Departamentit të Edukimit dhe Anglishtes, departament ky përbërës i Fakultetit të Shkencave Shoqërore si një njësi kryesore që bashkërendon mësimdhënien dhe kërkimin shkencor në fusha të përafërta ose të ndërthurura. Ky fakultet ofron programe studimi në programe të studimit Bachelor dhe Master, në përfundim të të cilave merret dhe diploma përkatëse. Sipas statutit të Universitetit, fakulteti përbëhet nga autoritetet drejtuese, organet drejtuese, njësitë bazë mësimore–shkencore, si edhe nga administrata.

### Vlerësimi i Treguesve të Matshëm:

#### **Struktura akademike e Fakultetit**

Fakulteti i Shkencave Shoqërore ka katër departamente:

- Departamenti i Shkencave Juridike
- Departamenti i Shkencave Politiko-Administrative
- Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme
- Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes.

Departamenti i Edukimi dhe Anglishtes, ofron tre programe studimi të ciklit të parë “Bachelor”, si edhe një program studimi të ciklit të dytë “Master Profesional”. Të gjitha programet e studimit janë të akredituara. Staf akademik dhe Institucioni angazhohen në përmbushjen e detyrimeve ligjore të rrjedhura nga akreditimi i programeve të studimit që ofron ky departament.

**Të dhëna për Stafin Akademik të Departamentit Përgjegjës**

Personeli akademik në Departamentin e Edukimit dhe Anglishtes, përbëhet nga *profesorë, lektorë dhe asistentë lektorë* me kohë të plotë ose të pjesshme, si dhe personel akademik i ftuar ku përfshihen profesorë dhe lektorë, etj.

Nga raporti i vlerësimit të brendshëm, Tabela nr.1, faqe 6, konstatohet se në këtë departament, për vitin akademik 2018-2019, **numri i personelit akademik efektiv është 10 (PAE)**, nga të cilët:

- 2 mbajnë titullin akademik “**Profesor i Asociuar**”,
- 8 janë me gradën shkencore “**Doktor i Shkencave**”.

Përsa i përket **personelit akademik me kontratë, janë gjithsej 14 (PAK)**, nga të cilët:

- 2 mbajnë titullin akademik “**Profesor**”,
- 3 “**Profesor i Asociuar**”,
- 6 janë me gradën shkencore “**Doktor i Shkencave**”,
- 3 kanë titullin “**Master i Shkencave**”.

(Tabela 1 - Aneksi bashkëngjitur)

Konstatohet se 11 anëtarë të tjerë të stafit akademik me kontratë, që angazhohen nga ky departament, vijnë nga departamentet e Fakulteteve të tjera në “Albanian University” dhe konkretisht nga *Departamenti i Farmacisë; Departamenti i Arkitekturës; Departamenti i Infermieri Fizioterapi; Departamenti i Psikologjisë; Departamenti i Stomatologjisë; Departamenti i Shkencave Politiko – Administrative; Departamenti i Inxhinierive*. Këto anëtarë kanë këto kualifikime:

- 7 me gradën shkencore “**Doktor i Shkencave**”
- 4 me kualifikimin “**Master i Shkencave**” (nga të cilët, 2 në ndjekje të studimeve doktorale).

(Tabela 2 - Aneksi bashkëngjitur)

Të gjitha të drejtat dhe detyrimet, si të personelit me kohë të plotë ashtu dhe të personelit akademik të ftuar, përcaktohen nga kontrata e punës, si edhe nga rregullorja e institucionit.

I gjithë dokumentacioni i duhur për punësimin, si edhe kontrata e punës e mbështetur në Kodin e Punës, në përcaktimet e ligjit për arsimin e lartë dhe në aktet e tjera, si për personelin me kohë të plotë ashtu dhe për personelin e ftuar, depozitohet dhe arkivohet në mënyrën e duhur në zyrën e burimeve njerëzore.

**Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion**

Për këtë pikë, institucioni ka dorëzuar të dhëna shtesë në formë tabelore mbi përditësimin e përbërjes së stafit PAE dhe PAK.

### 3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

#### Pjesa përshkrimore

Në Departamentin e Edukimit dhe të Anglishtes për vitin akademik 2018-2019 janë të punësuar personel akademik efektiv (PAE) dhe me kontratë (PAK). Personeli akademik efektiv është i punësuar në bazë të kontratave pa afat. Personeli akademik me kontratë është i punësuar me kontratë me afat 1 vjeçar ose semestral sipas nevojave të departamentit.

Në Statutin e “Albanian University”, **Kreu IV, Personeli, Neni 36, “Punësimi i personelit akademik”**, vihet re një politikë me kritere të artikuluar në mënyrë transparente dhe të qarta për rekrutimin e personelit

akademik. Ky rekrutim mbështetet në nevojat për personel akademik që departamenti i paraqet Dekanatit të Fakultetit, dhe më pas Rektoratit të "Albanian University".

### **Vlerësimi i Treguesve të Matshëm**

#### **☑ Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat**

Nga Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, Tabela nr.3, faqe 9, për vitin akademik 2018-2019 stafi në mbështetje të programit të studimit Bachelor në "Mësuesi në Arsimin Fillor", përbëhet nga:

**12 personel akademik efektiv (PAE)**, sipas këtyre kualifikimeve;

- 2 PAE me titull akademik "Profesor i Asociuar",
- 9 PAE me gradën shkencore "Doktor i Shkencave",
- 1 PAE me kualifikimin "Master i Shkencave" (në proces të studimeve doktorale), dhe

**11 personel akademik me kontratë (PAK)**, me kualifikimet e mëposhtme:

- 1 PAK me titullin akademik "Profesor",
- 2 PAK me titullin akademik "Profesor i Asociuar",
- 4 PAK me gradën shkencore "Doktor i Shkencave",
- 4 PAK me kualifikimin "Master i Shkencave" (nga të cilët, 1 në ndjekje të studimeve doktorale).

Konstatohet se 4 nga anëtarët e personelit akademik me kontratë që angazhohen në programin e studimit, janë personel akademik që vijnë nga departamentet e fakulteteve të tjera në UP "Albanian University" ku ato angazhohen kryesisht (*Departamenti i Farmacisë; Departamenti i Arkitekturës; Departamenti i Inxhinierive*).

Nga analiza e dokumentacionit shtesë të dorëzuar nga institucioni, është marrë në konsideratë që edhe personeli akademik efektiv, i punësuar në departamentet e tjera të Institucionit "Albanian University", por që është i angazhuar në mësimdhënien për programin Bachelor "Mësuesi për Arsimin Fillor" të konsiderohet si staf PAE për departamentin që mbulon këtë program studimi.

Në këtë vijë arsyetimi, nga këto tabela, është konstatuar që për vitin akademik 2018-2019 stafi në mbështetje të programit të studimit Bachelor në "Mësuesi në Arsimin Fillor", përbëhet nga:

**16 personel akademik efektiv (PAE)**, sipas këtyre kualifikimeve;

- 2 PAE me titull akademik "Profesor i Asociuar",
- 11 PAE me gradën shkencore "Doktor i Shkencave",
- 3 PAE me kualifikimin "Master i Shkencave" (dy prej të cilëve janë në proces doktorature), dhe

**7 personel akademik me kontratë (PAK)**, me kualifikimet e mëposhtme:

- 2 PAK me titullin akademik "Profesor",
- 1 PAK me titullin akademik "Profesor i Asociuar",
- 2 PAK me gradën shkencore "Doktor i Shkencave",
- 2 PAK me kualifikimin "Master i Shkencave"

Konstatohet se nga 16 PAE, 9 PAE janë personel i Departamentit të Edukimit dhe të Anglishtes, ndërsa 7 nga anëtarët e personelit akademik efektiv PAE që angazhohen në programin e studimit, janë personel akademik që vijnë nga departamentet e Fakulteteve të tjera në "Albanian University". (*Departamenti i Farmacisë; Departamenti i Arkitekturës; Departamenti i Psikologjisë; Departamenti i Inxhinierive*).

(Tabela 3/a - Aneksi bashkëngjitur)

Për vitin akademik 2017-2018 stafi në mbështetje të programit të studimit Bachelor në "Mësuesi në Arsimin Fillor", përbëhej nga:

**13 personel akademik efektiv (PAE)**, sipas këtyre kualifikimeve;

- 2 PAE me titull akademik "Profesor i Asociuar",

- 9 PAE me gradën shkencore “Doktor i Shkencave”,
- 2 PAE me kualifikimin “Master i Shkencave” (nga të cilët, 1 në ndjekje të studimeve doktorale), dhe

**14 personel akademik me kontratë (PAK), me kualifikimet e mëposhtme:**

- 2 PAK me titullin akademik “Profesor”,
- 2 PAK me titullin akademik “Profesor i Asociuar”,
- 5 PAK me gradën shkencore “Doktor i Shkencave”,
- 5 PAK me kualifikimin “Master i Shkencave” (nga të cilët, 2 në ndjekje të studimeve doktorale).

Konstatohet se 4 nga anëtarët e personelit akademik me kontratë që angazhohen në programin e studimit, janë personel akademik që vijnë nga departamentet e Fakulteteve të tjera në UP “Albanian University” ku ato angazhohen kryesisht (*Departamenti i Farmacisë; Departamenti i Arkitekturës; Departamenti i Inxhinierive; Departamenti Infermieri Fizioterapi*).

**(Tabela 3/b- Aneksi bashkëngjitur)**

**Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre**

Përsa i përket stafit akademik për programin e studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor”, për **vitin akademik 2018-2019**, nga Tabela nr.5 e RVB-së, rezultojnë që të jenë të punësuar si personel akademik efektiv 2 pedagogë me gradën Dr/PhD, 9 pedagogë të cilët janë Dr. në proces, 1 asistente-lektore me Msc. Përsa i përket personelit akademik me kontratë, rezultojnë 1 Prof.Asoc, 2 me gradën Dr/PhD, 4 Dr. në proces, si edhe 1 asistente-lektore me Msc. Raporti që del nga RVB për PAE/PAK është 62.5% me 37.5%. Sa i përket personelit administrativ rezultojnë 3 personel administrativ.

Ndërkohë, që nga dokumentacioni shtesë, ku edhe PAE i punësuar në departamentet e tjera do të konsiderohet si pjesë përbërëse e programit të studimit, rezultojnë që për **vitin akademik 2018-2019**, të jenë të angazhuar në mësimdhënien për këtë program studimi gjithsej 16 PAE, nga të cilët 2 Prof.Asoc, 11 me gradën Dr/PhD, 2 Dr. në proces, si edhe 1 asistente-lektore me Msc. Përsa i përket personelit akademik me kontratë PAK, rezultojnë gjithsej 7 PAK, nga të cilët 2 PAK me titullin Profesor, 1 Prof.Asoc, 2 me gradën Dr/PhD, si edhe 2 asistente-lektore me Msc. Raporti që del nga të dhënat e dokumentacionit shtesë për PAE/PAK është 69% me 31%.

Ndërsa për **vitin akademik 2017-2018**, stafi në mbështetje të programit të studimit Bachelor në “Mësuesi në Arsimin Fillor” përbëhet nga 13 personel akademik efektiv (PAE), nga të cilët 2 me titull “Profesor i Asociuar”, 9 me gradën “Doktor i Shkencave”, 2 PAE me kualifikimin “Master i Shkencave” (nga të cilët 1 në ndjekje të studimeve doktorale). Përsa i përket stafit akademik me kontratë (PAK), për vitin akademik 2017-2018, rezultojnë 2 PAK me titullin akademik “Profesor”, 2 PAK me titullin akademik “Profesor i Asociuar”, 5 PAK me gradën “Doktor i Shkencave”, si edhe 5 PAK me kualifikimin “Master i Shkencave” (nga të cilët 2 në ndjekje të studimeve doktorale). Raporti PAE/PAK për vitin akademik 2017-2018 rezultojnë 52% me 48%.

**(Tabela 3.1 /b- Aneksi bashkëngjitur)**

**Të dhënat sipas gjinisë**

Duke u mbështetur në dokumentacionin shtesë të dorëzuar nga institucioni sa i përket gjinisë, në stafin akademik PAE për programin e studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor”, për **vitin akademik 2018-2019**, ka vetëm 2 Prof.Asoc. të gjinisë mashkull. Femra gjithsej janë 10 nga të cilat 8 me gradën Dr/PhD, dhe 2 Dr në proces. Meshkuj gjithsej janë 6, 2 nga të cilët profesor i asociuar, 3 Dr/PhD dhe 1 Msc.

**(Tabela 3.1/a – Aneksi bashkëngjitur)**

Përsa i përket gjinisë, në stafin akademik PAE për programin e studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor”, për **vitin akademik 2017-2018**, femra gjithsej janë 9, nga të cilat 7 janë me gradën shkencore Dr/PhD, një është doktor në proces dhe një është me kualifikimin Master i Shkencave. Meshkuj gjithsej janë katër, nga të cilët 2 janë Prof.Asoc dhe 2 janë me gradën Dr/PhD.

**(Tabela 3.1/a – Anekse bashkëngjitur)**

**Të dhëna sipas moshës së personelit PAE dhe PAK**

Duke u mbështetur në dokumentacionin shtesë të dorëzuar nga Institucioni “AU”, përsa i përket moshës, në stafin akademik **PAE, në vitin akademik 2018-2019**, për programin e studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor”, 2 personel me titull Prof.Asoc. janë midis moshës 66-68 vjeç, 2 personel me gradën Dr/PhD janë në intervalin 25-35 vjeç, 4 personel me gradën Dr/PhD janë në intervalin 36-45 vjeç, 3 personel me gradën Dr/PhD janë në intervalin 46-55 vjeç ndërsa 2 personel me gradën Dr/PhD janë në intervalin 56-65 vjeç. 2 PAE Dr. në proces janë në intervalin 25-35 vjeç dhe 1 PAE me gradën Msc është në intervalin 25-35 vjeç. Personeli ndihmës akademik, përbëhet gjithsej nga 8 persona, që janë të gjithë në intervalin moshor 25-35 vjeç.

Përsa i përket moshës, në stafin akademik **PAE, në vitin akademik 2017-2018**, për programin e studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor”, 2 personel me titull Prof.Asoc. janë midis moshës 66-68 vjeç, 3 personel me gradën Dr/PhD janë në intervalin 25-35 vjeç, 3 personel me gradën Dr/PhD janë në intervalin 36-45 vjeç, 2 personel me gradën Dr/PhD janë në intervalin 46-55 vjeç ndërsa 1 personel me gradën Dr/PhD është në intervalin 56-65 vjeç. Është 1 PAE Dr. në proces që është në intervalin 25-35 vjeç dhe 1 PAE me gradën Msc është në intervalin 25-35 vjeç. Personeli ndihmës akademik, përbëhet gjithsej nga 8 persona, që janë të gjithë në intervalin moshor 25-35 vjeç.

**(Tabela 3.2/a – Aneksi bashkëngjitur)**

Duke u mbështetur sërish në dokumentacionin shtesë të dorëzuar nga Institucioni, përsa i përket moshës, në stafin akademik **PAK, në vitin akademik 2018-2019**, për programin e studimit Bachelor në “Mësuesi për arsimin fillor”, janë 2 profesorë me moshë në intervalin 56-65 vjeç. Gjithashtu, ka 1 personel me titull Prof.Asoc. në intervalin moshor 66-68 vjeç. Nga 2 personel me gradën Dr/PhD, njëri është në intervalin moshor 36-45 vjeç, 1 personel me gradën Dr/PhD është në intervalin 46-55 vjeç. Janë gjithsej 2 personel akademik me Msc ku që të dy ndodhen në intervalin 25-35 vjeç.

**(Tabelat 3.2/a, b – Aneksi bashkëngjitur)**

Përsa i përket moshës, në stafin akademik **PAK, në vitin akademik 2017-2018**, për programin e studimit Bachelor në “Mësuesi për arsimin fillor”, është 1 profesor me moshë në intervalin 56-65 vjeç. Gjithashtu, ka 3 personel me titull Prof.Asociuar, nga të cilët 2 janë në intervalin moshor 56-65 vjeç dhe 1 në intervalin moshor 66-68 vjeç. Nga 5 personel me gradën Dr/PhD, njëri është në intervalin moshor 25-35 vjeç, 1 në intervalin 36-45 vjeç, 2 personel me gradën Dr/PhD janë në intervalin 46-55 vjeç, dhe 1 në intervalin moshor 56-65 vjeç. Janë gjithsej 2 personel akademik në proces doktore, një nga të cilët është në intervalin 25-35 vjeç dhe një është në intervalin 46-55 vjeç. Të tre asistentë-lektorët janë në intervalin 25-35 vjeç.

**(Tabelat 3.2/a, b – Aneksi bashkëngjitur)**

**Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat**

Institucioni UP “Albanian University” i ka ndërtuar marrëdhëniet e punës bazuar në dy lloje kontratash: (1) Kontratat me stafin akademik me kohë të plotë dhe afat të pacaktuar për të gjitha kategoritë Profesor/Lektor/Asistent Lektor dhe (2) kontratat e stafit akademik me kohë të pjesshme me afat të caktuar. Të dy llojet e kontratave bazohen në Ligjin nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” si edhe në Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë. Ato përmbajnë përshkrimin e punës, kohëzgjatjen e kontratës, kushtet e punës, pagën mujore dhe shtesat mbi pagë, detyrimet dhe të drejtat me natyrë të përgjithshme, detyrimet dhe të drejtat specifike akademike dhe ato të lidhura me aktivitetet dhe kërkimin shkencor, detyrimin për konfidencialitet, detyrimet e punëdhënësit, modalitetet e zgjidhjes së kontratës së punës me marrëveshje të palëve, zgjidhjet e menjëhershme të kontratës së punës, si edhe masat disiplinore që jepen kundrejt punëmarrësit për shkelje të normave të parashikuara në kontratën e punës. Nga vizita në Zyrën e Burimeve Njerëzore në institucion u konstatua që kontratat kanë të bashkëlidhur formularin e ngarkesës së personelit akademik.

**Cilësia e stafit ndihmës/administrativ për çdo njësi bazë**

Institucioni “Albanian University” ka një strukturë të personelit administrativ i cili vepron si në nivel institucioni ashtu edhe në nivelin e njësisë bazë. Personeli administrativ i angazhuar për mbarëvajtjen e

Departamentit të Edukimit dhe të Anglishtes është i përbërë nga 2 punonjëse, nga të cilat njëra është me gradën Dr. ndërsa personeli tjetër është Msc. Personeli administrativ ka një performancë mjaft të mirë në përmbushje të kërkesave të veprimtarive administrative në mbështetje të programeve të studimit Bachelor dhe Master të ofruara nga departamenti.

**Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion**

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<b>III - PERSONELI I INSTITUCIONIT</b>	
<b>Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit të personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për punë, etj.</p>	<p>Nga takimet e realizuara me personelin e Zyrës së Burimeve Njerëzore, si edhe nga shqyrtimi i të gjithë dokumentacionit mbështetës, është konstatuar se Institucioni “Albanian University” ka një politikë transparente dhe të shprehur qartë për rekrutimin e personelit akademik, qoftë të atij me kohë të plotë, qoftë të atij me kohë të pjesshme.</p> <p>Konstatohet se në të gjitha fazat është respektuar baza ligjore, duke përfshirë Kodin e Punës në RSH, Ligjin 80/2015, aktet nënligjore të MARS, Statuti, si edhe rregullorja e “AU”.</p> <p>Për programin e studimit Bachelor në “Mësuesi në Arsimin Fillor”, janë të angazhuar 16 personel akademik efektiv dhe 7 personel akademik me kontratë. (Ky staf është përgjegjës për ofrimin e programit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor”)</p> <p>Personeli akademik efektiv i Institucionit “Albanian University” i angazhuar për programin e studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor”, mbulon rreth 79.4 % të ngarkesës së përgjithshme mësimore. Ky rezultat ka dalë nga analiza e raportit lëndë të mbuluara nga PAE kundrejt numrit të përgjithshëm të lëndëve. Në total, numri i lëndëve i paraqitur në dokumentacionin shtesë nga Institucioni për vitin akademik 2018-2019 është 34. Nga këto lëndë, 27 mbulohen nga PAE dhe 7 mbulohen nga PAK.</p> <p>Institucioni “Albanian University” ka politika transparente për vlerësimin e performancës së personelit akademik. Kjo pasqyrohet me anë të instrumentave të cilët përdoren për mbledhjen e të dhënave për këtë vlerësim. Ndër këta instrumenta mund të përmenden, Formulari për vlerësimin e stafit PAE/PAK, formulari i vlerësimit nga studentët, raporti i vlerësimit nga Njësia e Sigurimit të Brëndshëm të Cilësisë në “Albanian University”.</p> <p>Realizimi i të gjitha fazave të këtij procesi deri në arritjen e vlerësimit përfundimtar, konfirmohet si nga stafi, studentët, ashtu dhe nga Njësia e Sigurimit të Brëndshëm të Cilësisë.</p>
<b>Standardi III.2 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon listën e plotë të</p>	<p>Institucioni “Albanian University” ka zyrën e burimeve njerëzore, si njësi përgjegjëse për menaxhimin e të gjithë dokumentacionit dhe informacionit.</p> <p>Kjo zyrë në bashkëpunim dhe me Departamentin e Edukimit dhe Anglishtes disponojnë listat e plota për çdo semestër apo vit akademik dhe rinovojnë çdo të dhënë apo</p>




<p>personelit akademik për secilin semestër, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni publikon kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni angazhon si titullarë të lëndëve/moduleve për programet e studimeve të ciklit të parë, personel akademik që ka së paku gradën shkencore “Doktor,, ose titullin akademik “Docent”</p>	<p>dokumentacion që ka lidhje me personelin akademik dhe atë administrativ.</p> <p>Institucioni “Albanian University” ka kritere transparente dhe të publikuara përsa i përket rekrutimit të stafit akademik dhe atij administrativ, që janë në mbështetje të plotë me gjithë bazën ligjore të duhur. Të gjitha këto praktika publikohen në faqen zyrtare të institucionit: <a href="https://albanianuniversity.edu.al/sq/vende-vakante/">https://albanianuniversity.edu.al/sq/vende-vakante/</a> (aksesuar 14 Qershor 2019)</p> <p>Departamenti i Edukimi dhe i Anglishtes ka të angazhuar si titullarë për programin e studimit Bachelor në “Mësuesi në Arsimin Fillor” personel akademik me gradën “Doktor”, titullin Profesor i Asociuar, dhe Profesor.</p>
--	---

**Standardi III.3 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor, shkencor, si edhe administrativ për përbushjen e misionit të tij.**

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni vë në dispozicion personel të mjaftueshëm për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale (së paku 1 tutor/instruktor për 12 studentë).</p>	<p>Departamenti i Edukimit dhe i Anglishtes ka në funksion laboratorë të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike, si një pjesë e rëndësishme e kurrikulës së programit të studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor”. Kështu, ky departament kishte funksional laboratorin e informatikës me 25 kompjutera, Laboratorin e Edukimit Figurativ, si edhe Laboratorin e Muzikës.</p> <p>Gjithashtu, për nevojat e realizimit të orëve laboratorike të lëndëve të shkencave të natyrës, viheshin në dispozicion edhe ambjentet laboratorike të biologjisë dhe të kimisë të Fakultetit të Shkencave Mjekësore, e dhënë kjo e marrë nga vizitat në institucion. Shfrytëzimi i laboratorëve të kimisë dhe të biologjisë për llogari të Departamentit të Edukimit dhe të Anglishtes, realizohej me anë të rakordimeve ditore midis titullarëve të njësive bazë.</p> <p>Nga takimet që vlerësuesit e jashtëm zhvilluan me stafin akademik efektiv dhe atë me kontratë, u konstatua një angazhim serioz i stafit për përbushjen e objektivave të programit. Kjo gjë është vënë re edhe nga raporti i vlerësimit të brendshëm.</p> <p>Për instruktimin, udhëheqjen, monitorimin, si edhe vlerësimin e studentëve në praktikën profesionale, institucioni ka angazhuar dy pedagogë me eksperiencë të gjatë në mësimdhënie, personel akademik i mjaftueshëm për numrin e studentëve të cilët ndjekin praktikat profesionale.</p>
---	---

**Standardi III.4 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtjeshëm të personelit të tij.**

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtjeshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash të programeve të studimeve të ofruara.</p>	<p>“Albanian University” rezulton që ka një politikë të detajuar për kualifikimin e vazhdueshëm të personelit të saj akademik. Kjo politikë është një ndërthurje e trajnimeve të herëpashershme të organizuara edhe me profesorë të huaj dhe me ndarjen e ideve dhe përvojave midis kolegëve. Nga analiza e dokumentacionit “Trajnimi i stafit akademik”, rezulton se për vitin akademik 2018-2019, NjSBC ka organizuar trajnimin e stafit akademik me mbështetjen e Universitetit të Salernos në kuadër të Programit Erasmus+ në datat 25-26-27 Shtator 2018 me temën “Teknologjia dhe mësimdhënia: Rasti i Matematikës. Gjithashtu, NjSBC në datat 8 dhe 9 Tetor 2018 ka realizuar trajnimin me stafin administrativ lidhur me katalogimin e bibliotekës dhe trajnimin mbi paketën Microsoft Office.</p>
--	--




	<p>Nga takimet e realizuara në institucion u konstatua që zhvillohej një politikë pozitive për mbështetjen për kualifikimin individual të stafit.</p> <p>Institucioni disponon një bazë të dhënash të programeve të studimit të ofruara.</p>
--	--

**Konkluzionet e vlerësimit:**

“Albanian University” ka një sistem mirëfunksional dhe të strukturuar për burimet njerëzore. Ky sistem ka transparente politikat dhe praktikat e rekrutimit të stafit akademik dhe administrativ, politikat dhe praktikat e promovimit të personelit, si edhe politikat dhe instrumentat e vlerësimit të stafit akademik.

“Albanian University” ka politika të qarta dhe efektive për kualifikimin e vazhdueshëm të stafit, duke e realizuar këtë në mënyrë periodike. Gjithashtu, AU investohet në mbështetjen e kualifikimit individual si për përmirësimin e mësimdhënies dhe procesit të të nxënit, ashtu edhe për kërkimin shkencor.

**4. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit, logjistika, si edhe shërbime të tjera ndaj komunitetit**

**Pjesa përshkrimore**

UP “Albanian University” është një institucion i përbërë nga një kampus me katër godina kryesore, të gjitha me vendndodhje afër selisë kryesore të tij, në qendrës të Tiranës. I gjithë kampusi ka një sipërfaqe totale prej 10.718m<sup>2</sup>. Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes e zhvillon procesin akademik në godinën qendrore me sipërfaqe 3.996m<sup>2</sup> e cila ndodhet në Bulevardin “Zogu i Parë”. Ky departament, siç është theksuar edhe më sipër, është pjesë e Fakultetit të Shkencave Shoqërore. Infrastruktura e universitetit përmban auditorë të madhësive të ndryshme. Auditorët e mëdhenj janë funksionalë për zhvillimin e leksioneve me një numër të madh studentësh. Krahas tyre, janë edhe laboratorët për zhvillimin e orëve laboratorike. Të gjithë auditorët janë të pajisura me videoprojektorë dhe mjete të tjera teknologjie. Ambientet e brendshme të institucionit kanë të instaluar sisteme ngrohje-ftohje. “Albanian University” ka një sallë biblioteke të pajisur me dy kompjutera dhe 26 vende të ulura leximi. Biblioteka përmban një numër të konsiderueshëm titujsh, si në gjuhën shqipe, ashtu edhe në gjuhë të huaj, kryesisht në Anglisht. Biblioteka ofron një shërbim regjistrimi me anë të përdorimit të kartës së regjistrimit. Si rezultat i planifikimit për çdo vit të një fondi të veçantë për blerjen e literaturës, fondi i bibliotekës pasurohet në çdo fillim viti me literaturën e përshtatshme. Biblioteka e ofron shërbimin prej orës 08:00 deri në 16:00. Përveç fondit fizik të librave, biblioteka ofron edhe një librari elektronike, të quajtur QUESTIA, që funksionon gjatë 24 orëve, përmban 83.000 tituj akademikë dhe mbi 10 milion artikuj shkencorë. QUESTIA mund të aksesohet pa pagesë si nga stafi akademik ashtu edhe nga studentët për mbështetjen e zhvillimit të kërkimit shkencor.

Universiteti ofron sallë konferencash të pajisur me të gjithë teknologjinë multimediale, disa laboratorë, siç është Laboratori i Informatikës me 25 kompjutera dhe që është në funksion të Fakultetit të Shkencave Shoqërore. Universiteti ofron disa mjedise shlodhëse si kafeteri/fastfood, të cilat janë në dispozicion të studentëve të AU, të aksesueshëm lehtësisht dhe që u krijojnë komoditet për konsumim të ushqimit, si edhe për çlodhje.

Universiteti disponon edhe një librari ku studentët mund të gjejnë librat që përcaktohen si literaturë e detyrueshme apo e rekomandur në silabuset e programeve që ofrohen nga ky universitet. Universiteti ka edhe një shtëpi botuese, Albanian University Press, e cila ka botuar të gjithë titujt në kuadër të përmbushjes së kërkesave për tekste mësimore dhe shkencore.

Zyra e informacionit dhe e recepsionit ofron shërbim për çdo informacion që ka lidhje me programet e studimit dhe jo vetëm, për studentët e AU dhe për të gjithë personat e tjerë të interesuar.

Për rritjen e sigurisë fizike në institucion AU ka shërbim sigurie të ofruar me një sistem kamerash vëzhguese si në hollët e kateve ashtu edhe në mjediset e jashtme.

Kanali televiziv kombëtar UTV është një mundësi interesante dhe shërben për promovimin e aktiviteteve të ndryshme shkencore dhe kulturore të stafit dhe studentëve të këtij universiteti. Pjesëmarrja e studentëve dhe e pedagogëve të fakultetit në formatet e ndryshme televizive të ofruara nga ky televizion promovon më tej punën e këtij institucioni.




**Vlerësimi i Treguesve të Matshëm:** **Mjediset për Programin e studimit**

	Sasia	Sipërfaqja m <sup>2</sup>
• Salla për leksione	9	1038
• Klasa për seminare	10	473
• Salla për aktivitete promovuese	1	245
• Salla për praktikë lëndore/profesionale	0	0
• Laboratorë për lëndët	3	
• Laboratorë informatike	1	35
• Salla interneti	0	0
• Salla për bibliotekë	1	248.6
• Mjedis për fotokopjime, librari etj	1	7
• Zyrë informacioni për studentët	1	6
• Nyje hidrosanitare	6	106.4

**(Tabela 5/a – Aneksi bashkëngjitur)** **Mjediset për stafin:**

	Sasia	Sipërfaqja m <sup>2</sup>
• Mjedise për Dekanin/Kancelarin	1	9
• Zyra për sekretarinë mësimore	2	40
• Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore	1	20.3
• Zyra për personelin akademik	1	35
• Zyra për financën	2	47
• Zyrë për Njësinë e SBC	1	23.2
• Mjedise për stafin e shërbimit	1	20
• Nyje hidrosanitare për personelin akademik	2	6.4

**(Tabela 5/b – Aneksi bashkëngjitur)** **Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion****Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<b>V - INSTITUCIONI OFRON SHËRBIME DHE VENDOS NË DISPOZICION TË STUDENTËVE BIBLIOTEKA DHE BURIME TË TJERA INFORMACIONI</b>	
<b>Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme në sasi dhe cilësore;	Libraria e godinës qendrore të “Albanian University”, ku zhvillon aktivitetin e tij edhe Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes, ka në dispozicion të studentëve të programit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor” tituj në gjuhën shqipe dhe atë në gjuhë të huaj, sidomos në gjuhën angleze.  Biblioteka ka rreth 120 tituj nga të cilët 56 tituj të cilët janë të disponueshëm nga studentët dhe pedagogët për nevojat e tyre, si për mësimdhënie, ashtu edhe për kërkimin shkencor.  Biblioteka ka 26 vende studimi dhe 2 kompjutera.
<b>Kriteri 2</b> Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit;	
<b>Kriteri 3</b> Në bibliotekë ka botime periodike dhe programe kompjuterike, si libraritë elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit;	

<p><b>Kriteri 4</b> Përgjegjësit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për të;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Biblioteka shpall oraret e shërbimit në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>Biblioteka ka siguruar edhe burime elektronike, siç është QUESTIA, e cila përmban rreth 83.000 libra akademikë dhe mbi 10 milion artikuj shkencorë, e disponueshme në 24 orë të ditës dhe pa pagesë, si nga studentët ashtu edhe nga stafi akademik, por institucioni aktualisht nuk ka instrumente matës për të nxjerrë të dhëna të sakta për numrin e studentëve të cilët aksesojnë në librarinë elektronike.</p> <p>Botim shkencor <i>Optime</i> i “Albanian University”, një revistë shkencore periodike, është një mundësi e mirë që studentët të gjejnë artikuj shkencorë në ndihmë të formimit të tyre profesional.</p> <p>Institucioni planifikon çdo vit një fond të veçantë për blerjen e literaturës së specializuar për çdo program studimi dhe në mbështetje të kërkimit shkencor. Fondi i bibliotekës pasurohet çdo vit me literaturë e përshtatshme të bazuar kryesisht në kërkesat e gjeneruara nga departamenti në fund të vitit pasardhës. Institucioni shpenzon çdo vit 30.000 lekë fonde të planifikuara për blerjen e literaturës së specializuar për çdo program studimi.</p> <p>Biblioteka ka të shpallura oraret e studimit dhe është funksionale në ndihmë të nevojave të studentëve.</p>
<p><b>Standardi V. 2- Institucioni vendos në dispozicion të studentëve laboratorë dhe mjedise të përshtatshme mësimore për formimin praktik.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Pajisjet e mjedisve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator.</p> <p><b>Kriteri 5</b> Institucioni, në varësi të programeve të studimeve, disponon kompjutera në laboratorët e teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale si programe për statistikë, linguistikë, arkitekturë, inxhienieri, ekonomi, mjekësi, programestimulimi për shkencat sociale etj.</p> <p><b>Kriteri 6</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme për zhvillimin e praktikave profesionale.</p>	<p>Nga RVB, por edhe gjatë vizitës në institucion, është konstatuar që institucioni disponon auditore leksionesh dhe salla seminaresh me hapësira të mjaftueshme dhe komode për akomodimin normal të studentëve.</p> <p>Institucioni ka zyra dhe mjedise të tjera, si salla konferencash, për zhvillimin normal të punës së stafit akademik dhe administrativ.</p> <p>Mjediset mësimore janë të pajisura pjesërisht me mjete teknologjike për zhvillimin normal të procesit mësimor, në kuadër të realizimit me sukses të programit të studimit.</p> <p>Institucioni ka në zotërim një laborator informatike me 25 kompjutera për plotësimin e kërkesave të programit, numër ky proporcional me numrin e studentëve të regjistruar në program.</p> <p>Gjithashtu, duke qënë se programi mësimor parashikon orët e praktikave laboratorike, për nevojat e realizimit të orëve laboratorike të lëndëve të shkencave të natyrës, viheshin në dispozicion edhe ambientet laboratorike të biologjisë dhe kimisë të Fakultetit të Shkencave Mjekësore, e dhënë kjo e marrë nga vizitat në institucion.</p> <p>Institucioni ka organizuar në mënyrë të planifikuar zhvillimin e praktikave profesionale nëpërmjet bashkëpunimit me institucione të tjera, si me drejtoritë arsimore dhe zyrat arsimore, apo edhe me “Albanian College” me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi.</p>

### **Konkluzione të GVJ:**

Institucioni ka vënë në dispozicion të programit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor” infrastrukturën e nevojshme, të tillë si auditorë, laboratorë, zyra, salla konferencash, bibliotekë, etj, të cilat plotësojnë nevojat për realizimin e procesit mësimor për këtë program studimi.

Sugjerohet pasurimi i mëtejshëm i fondit hardcopy të titujve të bibliotekës në funksion të këtij programi studimi, akomodimi i sallës së leximit të studentëve në një mjedis me dritë natyrale si dhe ngritja e intrumenteve matës për numrin e studentëve dhe lektorëve që frekuentojnë bibliotekën online “Questia”.

## **5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare**

### **Pjesa përshkrimore**

“Albanian University” ka të përcaktuar një politikë të qartë financiare, ka burime të financimit, kostot për secilin zë buxhetor, kostot për student, si edhe kostot për të gjitha kapacitetet e logjistikës. Burimet financiare të “Albanian University” janë kryesisht nga tarifat e shkollimit. Gjithashtu, këto kosto mbulohen edhe nga disa aktivitete tregtare siç janë të ardhurat që merren nga shërbimet e mensës, kafeterisë etj.

Të gjitha të ardhurat nga tarifat e shkollimit të studentëve shkojnë për rritjen e kapaciteteve dhe përmirësimin e infrastrukturës. “Albanian University” ka një njësi qendrore e cila merret me menaxhimin e burimeve financiare dhe me kontrollin e tyre. Të ardhurat dhe financimet në institucion regjistrohen, përpunohen dhe auditohen mbi bazën e një numri unik identifikues (NIPT) të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit.

### **Vlerësimi i Treguesve të Matshëm:**

#### **Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi:**

- *Grantet për kërkim*  
Nuk ka të dhëna të veçanta për programin Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor”.
- *Konsulencat, shërbimet*  
Nuk ka të dhëna të veçanta për programin Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor”.
- *Tarifat për dhe gjatë shkollimit*  
Për vitin akademik 2017-2018 ka qënë 99.4 % e koston së buxhetit  
Për vitin akademik 2018-2019 ka qënë 99.1 % e koston së buxhetit
- *Sponsorizimet*  
Nuk ka të dhëna të veçanta për programin Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor”.
- *Shërbimet trajnuese (kualifikimi i vazhdueshëm)*  
Nuk ka të dhëna të veçanta për programin Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor”.
- *Donacionet, aktivitetet sigurorese, fondacione etj*  
Nuk ka të dhëna të veçanta për programin Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor”.
- *Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, rezidencat, etj)*  
Për vitin akademik 2017 -2018 ka qënë 0.6 % e koston së buxhetit.  
Për vitin akademik 2018 -2019 ka qënë 0.9 % e koston së buxhetit.

**(Tabela 6 – Aneksi bashkëngjitur)**

#### **Shpenzimet për studentët dhe kostot e studimit për student për vit akademik**

Për vitin akademik 2018-2019 kostot e shpenzimit për student për një vit akademik kanë qënë 900 Euro.

**Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion**

Bilancet vjetore dhe raportet e auditit të pavarur

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<b>II - ORGANIZIMI, DREJTIMI, SI EDHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b>	
<b>Standardi II.5 - Institucioni vlerëson dhe dokumenton gjendjen e tij financiare.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm ose të brendshëm) të situatës financiare të tij;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative, etj;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>“Albanian University” i ka të dokumentuara raportet financiare për vitin akademik 2017-2018 dhe 2018-2019.</p> <p>“Albanian University” harton për çdo vit akademik një raport financiar që përmban të gjithë zërat financiarë të të ardhurave si edhe ndarjen e burimeve financiare sipas zërave të buxhetit. Institucioni realizon një audit të përvitshëm, nga një kontabël i miratuar, raportet e të cilit janë të hartuara sipas standardeve përkatës.</p> <p>Raporti i auditit paraqet të gjitha zërat sipas formatit të kërkuar.</p> <p>Duke qënë se institucioni nuk ka përfitime nga asnjë grant i huaj, raporti i auditit përmban një pasqyrë referuar bilancit vetëm për të ardhurat dhe shpenzimet.</p>
<b>VI - BURIMET FINANCIARE DHE VLERËSIMI FINANCIAR</b>	
<b>Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni harton një raport financiar që përmban një pasqyrë tëhollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni dëshmon një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>Raporti i auditit paraqet një tablo të plotë të situatës financiare sipas zërave të përcaktuar.</p> <p>Nga këto të dhëna, situata e deritanishme financiare dëshmon se “Albanian University” ka qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të këtij programi si edhe ka kapacitete financiare të mjaftueshme për të vijuar veprimtarinë në vijim.</p>
<b>Konkluzionet e vlerësimit:</b>	
<p>“Albanian University” ka një politikë financiare të plotë dhe të gjitha praktikat që aplikohen për zbatimin e kësaj politike respektojnë standardet për burimet, monitorimin dhe vlerësimin financiar.</p> <p>Nuk konstatoam të ketë një buxhet qoftë edhe modest për grantet kërkimore-shkencore dhe shërbimet trajnuese.</p>	

**6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë**

**Pjesa përshkrimore**

NJSBC, në Albanian University, është krijuar si zyrë në fillim të vitit akademik 2009-2010. Me hyrjen në fuqi të Ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me vendim të Senatit Akademik (nr.4, dt.22/12/2016) është ngritur Komisioni i Përhershëm për Vlerësimin Institucional.

NJSBC ushtron funksion mbështetës, monitorues, vlerësues, si edhe ofron ekspertizë për zhvillimin e proceseve të sigurimit të cilësisë. Gjithashtu, NJSBC ka funksion të hartojë politikat e vetëvlerësimit dhe të përcaktojë kriteret e vlerësimit, të cilat realizohen nëpërmjet anketimeve dhe raporteve vlerësuese.

Që prej vitit 2016, NJSBC, në bashkëpunim me departamentet funksionon një komision Ad-Hoc, në nivel njësie bazë, për të vlerësuar programet mësimore, literaturën, si edhe format e vlerësimit.

**(Tabela 7 – Aneksi bashkëngjitur)**

**Vlerësimi i Treguesve të Matshëm:**

**Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:**

- *Sa anketime kanë bërë me studentët*

Për programin e studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor” kryen dy anketime në vit, në fund të çdo semestri dhe një takim në vit me fokus-grupe.

- *Sa studentë janë anketuar?*

Gjatë vizitës në institucion me përfaqësues të NJSBC u konstatua se gjatë vitit akademik 2018-2019, për programin e studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor” pjesëmarrja në anketime ishte 65.5% dhe pjesëmarrja në takimin me fokus grupe (6-8 anëtarë).

- *Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë?*

Nga RVB, por edhe nga takimi me studentët e programit të studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor”, konstatoam se vlerësimet janë pozitive dhe studentët nuk kanë paraqitur problematika specifike në lidhje me programin e studimit në fjalë.

- *Cilat kanë qenë hapat e mëtejshëm?*

Rezultatet e anketimeve përpunohen dhe dërgohen në njësinë bazë në të cilën ofrohet programi i studimit duke ruajtur konfidencialitetin. Departamenti merr masat për zgjidhjen e problematikave që mund të parashtrijnë studentët në lidhje me lëndët, literaturën, lektorët etj.

**Kontrolli i brendshëm i cilësisë**

Kontrolli i brendshëm i cilësisë së programeve të studimit realizohet në mënyrë periodike në fund të çdo semestri, nëpërmjet anketimeve, fokus-grupeve dhe vetëvlerësimit që realizojnë pedagogët.

**Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti**

Që prej vitit 2016, NJSBC, në bashkëpunim me departamentet funksionon në nivel njësie bazë, duke ngritur grupe pune Ad-hoc për Sigurimin e Cilësisë, për të vlerësuar programet mësimore, kurrikulën, syllabuset, si edhe format e vlerësimit.

**Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre**

Departamenti, çdo vit akademik, harton raportin semestral dhe vjetor të vetëvlerësimit, në të cilin pasqyrohen të dhënat e stafit akademik dhe rekrutimet, literatura e përdorur, marrëveshjet e bashkëpunimit, si edhe veprimtaria kërkimore-shkencore.

**Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike**

Nuk janë shfaqur problematika specifike në lidhje me këtë program studimi dhe procesin e mësimdhënies dhe për rrjedhojë, nuk ka lindur nevoja për hartimin e politikave përmirësuese.

**Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion**

Statistika për pjesëmarrjen e studentëve në anketime dhe model tip të anketës së realizuar.

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<p align="center"><b>II - ORGANIZIMI, DREJTIMI, SI EDHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b>  <b>Standardi II.3 - Institucioni, për akreditimin e programeve të studimeve, përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e tyre.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni publikon rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta:</p> <p>Të tërthorta:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve;</li> <li>Sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit;</li> <li>Pyetje konceptuale;</li> <li>Intervista;</li> <li>Etj.</li> </ol> <p>Të drejtpërdrejta:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara);</li> <li>Dëgjime në auditor;</li> <li>Vlerësimi me nota/pikë;</li> <li>Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktikë;</li> <li>Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët (detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, provimet, referatet);</li> <li>Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</li> <li>Etj.</li> </ol>	<p>Konstatohet që institucioni nëpërmjet NJSBC kryen raporte vlerësimi periodikë semestralë dhe publikon nëpërmjet buletinëve vjetore rezultatet e anketimeve.</p> <p>Konstatohet që institucioni aplikon metoda të ndryshme vlerësimi të tërthorta nëpërmjet sondazheve të studentëve, sondazheve të vlerësimit të mësimdhënies, realizimit të intervistave me fokus-grupe dhe të drejtpërdrejta si dëgjimi në auditor, vlerësimi i rezultateve të arritura nga studentët, vëzhgime gjatë procesit të realizimit të projekteve dhe praktikës profesionale.</p>



## VIII - INSTITUCIONI GARANTON SIGURIMIN E CILËSISË

### Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.

**Kriteri 1** Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;

**Kriteri 2** Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;

**Kriteri 3** Institucioni harton një politikë të qartë dhe ndjek procedurën e vlerësimit periodik të efikasitetit të veprimtarive që kryen për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve që ofron;

**Kriteri 4** Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve që ofron;

**Kriteri 5** Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;

**Kriteri 6** Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.

Konstatohet që “Albanian University” është akredituar në nivel institucional nga Bordi i Akreditimit me nr.90, dt.20/10/2017, me kohëzgjatje 2 vjeçare, aktualisht është në proces riakreditimi institucional.

Konstatohet që Institucioni ndjek procedura korrekte për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre dhe aplikon mekanizmat formalë për miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsim Fillor”.

Konfirmohet që institucioni synon të përçojë vlerat dhe rëndësinë që ka një program studimi Bachelor në “Mësuesi për Arsim Fillor” tek studentët dhe personeli nëpërmjet mekanizmave formalë, siç është edhe procesi i riakreditimit, për miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të këtij program studimi.

Bazuar në legjislacionin në fuqi dhe në aktet e tij nënligjore, institucioni harton strategji dhe politika për rritjen e vazhdueshme të këtij program studimi.

#### Konkluzionet e vlerësimit:

Nëpërmjet NJSBC, institucioni kryen raporte vlerësimi periodikë vjetorë. AU aplikon metoda të ndryshme vlerësimi nëpërmjet sondazheve të studentëve, sondazheve të vlerësimit të mësimdhënies, realizimit të intervistave me fokus-grupe dhe të drejtpërdrejta etj.

NJSBC, sekretaria dhe stafi mbështetës kryejnë punë serioze dhe në respekt të parimeve etike të cilët synojnë të përçojnë vlerat dhe rëndësinë që ka programi i studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsim Fillor” tek studentët nëpërmjet mekanizmave formalë, siç është edhe procesi i riakreditimit.

Institucioni ndjek procedura korrekte për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të këtij program studimi dhe është i prirur të përditësojë programin e studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsim Fillor” nga viti 2017, akreditimi i parë.

### POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

#### 7. Programi i studimit, organizimi i tij

##### Pjesa përshkrimore

Programi i studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor”, është licencuar me Urdhër të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës nr. 251 datë 02.06.2011, si program studimi i ciklit të parë, me kohëzgjatje 3 viti akademik, 180 ECTS. Programi është akredituar për herë të parë me kusht me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Sportit Nr. 381, datë 08.07.2016, sipas Vendimit Nr. 167, datë 16.05.2016 të Këshillit të Akreditimit. Pas procedurës për vlerësimin e plotësimin të kushteve, të kryer nga ASCAL, programi akreditohet me

Vendim nr. 34, datë 19.05.2017 të Bordit të Akreditimit, me kohëzgjatje 2 vite akademike. Në Shtator të vitit 2017 ky program studimi është rishikuar në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë nr.80/2015.

Ky program studimi funksionon në bazë të rregullores së tij, në të cilën përcaktohen qartë objektivat e programit të studimit, struktura e programit të studimit për secilin profil, format e vlerësimit dhe të drejtat e studentit. Plan-programi i studimit është hartuar konform VKM nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL”, i ndarë në kredite dhe disiplina karakterizuese përkatëse. Kreditet janë të ndara në leksione, seminare, ushtrime në auditor, laborator, praktikë, si edhe punë e pavarur e studentëve (Tabela 8 – Anekse bashkëngjitur).

#### **Vlerësimi i Treguesve të Matshëm:**

**Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi**

Programin e studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor” është licencuar me Urdhër të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës nr. 251 datë 02.06.2011, si program studimi i ciklit të parë. Ka filluar aktivitetin e tij në vitin akademik 2010-2011.

Ky program studimi funksionon në bazë të rregullores së tij, në të cilën përcaktohen qartë objektivat e programit të studimit, struktura e programit të studimit për secilin profil, format e vlerësimit dhe të drejtat e studentit. Plan-programi i studimit është hartuar bazuar në legjislacionin në fuqi, i ndarë në kredite dhe disiplina karakterizuese përkatëse. Kreditet janë të ndara në leksione, seminare, ushtrime, laborator, praktikë, si edhe punë e pavarur e studentëve.

**Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë, etj.)**

- 1 Vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor
- 1 Semestër ka 15 javë mësimore në auditor
- 1 orë mësimore 50 minuta

**Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë**

Programi i studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor” ka në total 180 ECTS, për tre vite akademike, 60 ECTS çdo vit dhe 30 ECTS çdo semester. Konstatohet që ndarja e kategorive të veprimtarive formuese nuk është në përputhje të plotë me VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL”. Lëndët plotësuese të kategorisë D si gjuhë e huaj, njohuri informatike janë pasqyruar në “Plani mësimor të ndarë në kategori formuese” (Tabela 9 – Anekse bashkëngjitur), si lëndë të kategorisë C (lënde ndërdisiplinore) duke cënuar raportin e % të kategorive formuese bazuar në VKM e sipërcituar.

**Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit**

- Për Leksionet 10.5 orë në auditor dhe 14.5 orë punë e pavarur e studentit
- Për Seminaret 7.5 orë në auditor dhe 17.5 orë punë e pavarur e studentit
- Për Praktikat lëndore 2 orë në auditor dhe 2.5 orë punë e pavarur e studentit
- Për Praktikën Profesionale 22.5 orë në auditor dhe 2.5 orë punë e pavarur e studentit
- Provimi përfundimtar 2 orë në auditor dhe 23 orë punë e pavarur e studentit

**Ndryshimet në Planet Mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara**

Plan programi i studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor” rezultojn të ketë ndryshuar me Vendim Senati nr.19 dt.15.09.2017, ndryshime të cilat konsistojnë në terminologji, bashkim lëndesh dhe ndryshim ECTS si më poshtë: ( **Tabela 10 – Anekse bashkëngjitur**)

1. *Lënda Edukim Muzikor (4 ECTS) + Lënda Didaktikë e Edukimit Muzikor (4 ECTS), ndryshon Edukim Muzikor dhe Didaktika e Edukimi Muzikor (6 ECTS);*
2. *Lënda Aritmetikë (4 ECTS) + Lënda Didaktikë e Matematikës për CU (4 ECTS), ndryshon Aritmetikë dhe Didaktikë e Matematikës për CU (5 ECTS);*
3. *Lënda me zgjedhje Menaxhim Klase (4 ECTS), ndryshon Lëndë (detyruese) Menaxhim Klase (3 ECTS).*

**Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës**

Personeli akademik i angazhuar në realizimin e programin të studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor” është 79.4 % personel akademik efektiv (nga Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes, dhe personel akademik që vijnë nga departamentet e Fakulteteve të tjera në “Albanian University si Departamenti i Farmacisë, Departamenti i Arkitekturës, Departamenti i Psikologjisë, Departamenti i Inxhinierive) dhe 20.6 % personal akademik me kontratë.

Ndërsa ngarkesa mësimore që mbulon stafi akademik PAE është 68.8 % të kurseve, ndërsa PAK mbulon 31.2% të ngarkesës mësimore në programin e studimit, për vitin akademik 2018-2019 (**Tabela 11 – Anekse bashkëngjitur**).

**Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.**

Syllabuset janë hartuar sipas standarteve të përcaktuara në VKM nr.41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL”. Në çdo syllabus janë të përcaktuara qartë: Emërtimi i lëndës, Viti/semestri kur zhvillohet lënda, Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën, Kategoria e veprimtarisë formuese, Njohuritë dhe Aftësitë që duhet të marrë studenti, Shpërndarja e ngarkesës, Format e vlerësimit dhe mësimdhënies.

**Analizë e cilësisë së syllabuseve**

Tekstet e përdorura në çdo syllabus i ofrohet studentit në gjuhë shqipe. Konstatohet që literatura e detyruar në disa syllabuse si “Politikat arsimore” dhe “Edukim qytetar dhe demokratik i fëmijëve”, tejkalon masën e aftësive përthithëse të studentëve të nivelit bachelor. Gjithashtu rezultojn se literatura e detyruar dhe ndihmëse është e përcaktuar qartë por, në disa syllabuse nuk është bashkëkohore.

**Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion**

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
<b>I - PROGRAMET E STUDIMEVE TË OFRUARA</b>	
<b>Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</b>	

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p><b>Kriteri 2</b> Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Konfirmojmë që programi i studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor” me kohëzgjatje 3 vite akademik, 180 ECTS, është akredituar për herë të parë me kusht me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Sportit Nr. 381, datë 08.07.2016, sipas Vendimit Nr. 167, datë 16.05.2016 të Këshillit të Akreditimit. Pas procedurës për vlerësimin e plotësimin të kushteve, të kryer nga ASCAL, programi akreditohet me Vendim nr. 34, datë 19.05.2017 të Bordit të Akreditimit, me kohëzgjatje 2 vite akademike.</p> <p>Konfirmojmë që ky program studimi është me kohëzgjatje 3 vite akademike, organizuar në dy semestre dhe çdo vit akademik studenti përfiton 60 ECTS.</p>
<p><b>II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b></p> <p><b>Standardi II.4 - Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara dhe informuese.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për përmbajtjen e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për lëndët me zgjedhje apo të detyruara për semestër;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ ndjekjen e programit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikatat, ushtrimet apo orët e laboratorit, etj.</p>	<p>Konfirmojmë që studentët janë të pasjitur me informacion rreth kurseve dhe syllabusve që ky program studimi ofron.</p> <p>Gjatë javës orientuese në fillim të vitit akademik studentët informohen mbi programet e studimit, orët në auditor, frekuentimin/ndjekjen e programit, modulet dhe syllabuset që institucioni ofron në formë elektronike dhe hardcopy.</p>
<p><b>Konkluzionet e vlerësimit:</b></p> <p>Programi i studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor”, me kohëzgjatje 3 vite akademike, 180 ECTS, është akredituar për herë të parë me kusht me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Sportit Nr. 381, datë 08.07.2016, sipas Vendimit Nr. 167, datë 16.05.2016 të Këshillit të Akreditimit. Pas procedurës për vlerësimin e plotësimin të kushteve, të kryer nga ASCAL, programi akreditohet me Vendim nr. 34, datë 19.05.2017 të Bordit të Akreditimit, me kohëzgjatje 2 vite akademike. Plan programi i studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor” rezulton të jetë ndryshuar me Vendim Senatit nr.19 dt.15.09.2017.</p> <p>Sugjerojmë riorganizim të plan programit Bachelor në f“Mësuesi për Arsimin Fillor” në masën 20 % duke u bazuar në “Standartet e formimit të përgjithshëm të mësuesit fillor” publikuar nga IZHA ( sot ASCAP) (2016) dhe në respektim të VKM nr.41, datë 24.1.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL”, për kategorizimin e saktë të veprimtarive formuese për programin Bachelor.</p>	

**8. Mësimdhënia**

**Pjesa përshkrimore**

Format kryesore të procesit mësimor në programin e studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsim Fillor” janë leksionet, seminarët, si edhe ushtrimet. Procesi i mësimdhënies shkon në interes të zhvillimit profesional të studentëve dhe respektimit të përvojës individuale të tyre nëpërmjet realizimit të projekteve individuale në çdo lëndë. Pedagogët përdorin teknologjinë për realizimin e procesit mësimor dhe përipiqen të krijojnë një mjedis motivues për t’i mbështetur studentët në arritjet e tyre akademike.

#### **Vlerësimi i Treguesve të Matshëm:**

Në programin e studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsim Fillor” format për realizimin e procesit të mësimdhënies janë leksionet, seminarët, ushtrimet, projekte lëndore, testet, provimet, si edhe praktika profesionale. (Tabela 12 – Aneksë bashkëngjitur)

#### **Format e kontrollit të njohurive**

Kontrolli i njohurive në këtë program studimi realizohet nëpërmjet provimeve me shkrim në përfundim të çdo kursi, me detyrat e kursit dhe projekte në çdo lëndë, me dosje për realizimin e praktikës profesionale dhe me komision ad-hoc për mbrojtjen e tezës së diplomës dhe provimin e formimit.

(Tabela 13 – Aneksë bashkëngjitur)

#### **Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë, etj**

Konstatohet që studentët janë pjesë e komisioneve të ndryshme të ngritura në nivel departamenti dhe në aktivitetet shkencore të organizuara nga departamenti. Në hartimin e RVB për këtë program studimi, një nga katër anëtarët e grupit të punës është studente aktuale e programit të studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsim Fillor”.

#### **Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion**

Dosjet individuale të studentëve që dëshmojnë zhvillimin e praktikës profesionale.

## **9. Studentët**

### **Pjesa përshkrimore**

Të drejtën për të aplikuar në këtë program studimi e kanë kandidatët të cilët kanë kryer procesin e aplikimit on-line në portalin e Maturës Shtetërore. Procedura e aplikimit të kandidatëve kryhet sipas udhëzimeve në fuqi nga MARS.

Kriteret e pranimit të studentëve zhvillohen konform akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Në respektim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, AU, me vendim Senati, ka përcatuar kriteret e pranimit për këtë program studimi: 70% mesatarja e ponderuar sipas VKM në fuqi dhe 30% mesatarja e lëndëve që përcaktohen çdo fillim viti akademik për këtë program studimi. Kandidatët të cilët shpallen fitues duhet të regjistrohen dhe të dorëzojnë personalisht dokumentacionin e kërkuar sipas Udhëzimeve që dalin nga MARS.

Koha e zgjatjes së studimeve është kryesisht 3 vite akademike. Nota mesatare në hyrje për vitin akademik 2018-2019 është 7.7. [Evidenca: **Numri i studentëve, cilësia në hyrje dhe në dalje**].

Numri i të regjistruarve për vitin akademik 2018-2019 është 16, ndër të cilët 14 të regjistruar për herë të parë dhe 2 transferim studimesh (Tabela 14 – Aneksë bashkëngjitur).

### **Vlerësimi i Tregues të Matshëm:**

**Procedurat e pranimit të studentëve**

Kriteret e pranimit të studentëve zhvillohen konform akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Në respektim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, AU, me vendim Senati, ka përcatuar kriteret e pranimit për këtë program studimi: 70% mesatarja e ponderuar sipas VKM në fuqi dhe 30% mesatarja e lëndëve që përcaktohen çdo fillim viti akademik për këtë program studimi.

**Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve**

Mesatarja e studentëve të regjistruar në këtë program studimi, për vitin akademik 2018-2019 është 7.7, mbi mesataren e vendosur nga MARS, për studentët të cilët duhet të ndjekin programet e studimit në fakultetet e edukimit .

**Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë). Nota Mesatare**

Studentët e regjistruar për herë të parë në vit të parë, për vitin akademik 2017-2018, pas akreditimit të parë, ka qënë 6.8. Ndërsa për vitin akademik 2018-2019, ka qënë 7.7. (Tabela 14 – Aneksë bashkëngjitur)

**Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse). Nota Mesatare**

Nota mesatare e studentëve të diplomuar, në vitin akademik 2018-2019 është 7.81.

**Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend**

Mobiliteti i studentëve në programin e studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsim Fillor”, ndër vite ka ardhur në rënie, për vitin akademik 2017-2018 ka qënë 15 studentë, ndërsa për vitin akademik 2018-2019 është 2 studentë.

**Të dhëna për punësimin e studentëve**

Në programin e studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsim Fillor” rezulton se për periudhën 2017-2019 numri total i të punësuarve në përputhje me diplomën janë 15, ndërsa pjesa tjetër 93 janë në ndjekje të programeve të dyta studimi që Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes ofron (Tabela 15 – Aneksë bashkëngjitur).

**Numri total të diplomuarve**

Rezulton se numri total i të diplomuarve, pas akreditimit të parë, nga viti 2017 është 108.

**Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)**

Numri total i të punësuarve në përputhje me diplomën per programin e studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsim Fillor është i vogël 15, pasi pjesa më e madhe e të diplomuarve menjëherë pas përfundimit të



ciklit të parë të studimeve ndjekin studimet e ciklit të dytë, për formimin e plotë akademik si mësues të ciklit fillor, sipas Ligjit të Arsimit të Lartë në fuqi. (Tabela 15 – Aneksë bashkëngjitur)

**Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)**

Numri total i të punësuarve jo në përputhje me diplomën rezulton të jetë 93, sipas RVB, (Tabela 15 – Aneksë bashkëngjitur).

**Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion**

Të dhënat statistikore nga sekretaria mësimore mbi mesataren dalëse të studentëve të programit të studimit në fjalë, ndër vite.

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
<b>IV - INSTITUCIONI MBRON TË DREJTAT E STUDENTËVE</b>	
<b>Standardi IV.1 - Institucioni ndjek një politikë të mirëpritjes së studentëve të rinj.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Pranimi në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi.</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni i Arsimit të Lartë propozon kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilët kanë mbaruar Maturën Shtetërore, për t’u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>Konfirmojmë që procedurat dhe kriteret e pranimit janë konform akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi si edhe në përputhje me politikat e hartuara nga institucioni.</p> <p>Konfirmojmë që AU, me vendim Senati, ka përcaktuar kriteret e pranimit për këtë program studimi: 70% mesatarja e ponderuar sipas VKM në fuqi dhe 30% mesatarja e lëndëve që përcaktohen çdo fillim viti akademik për këtë program studimi.</p>
<b>Standardi IV.2 - Institucioni informon studentët në lidhje me politikat e punësimit.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Studentët vlerësojnë pedagogun e çdo lënde, në përfundim të semestrit;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Studentët informohen mbi mundësitë për punësim pas diplomimit në këtë program studimi.</p>	<p>Konfirmojmë që studentët, gjatë javës së parë të vitit akademik, informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p> <p>Konstatojmë që studentët vlerësojnë pedagogun e çdo lënde, në përfundim të kursit.</p> <p>Konstatojmë që studentët orientohen për zhvillimin e karrierës.</p> <p>Nga takimi me studentët konstatojmë se ata janë të mirëinformuar mbi vlefshmërinë e programit që ndjekin, mundësitë për punësim dhe ofertat formuese pas diplomimit për këtë program studimi.</p>
<b>Standardi IV.3 - Institucioni disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve, në ciklin e parë;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin</p>	<p>Dëshmojmë që institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve, për numrin e studentëve të regjistruar, për tërheqjet dhe largimet para përfundimit të këtij program studimi si edhe për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomim.</p>

zhvillohet programi i studimeve; <b>Kriteri 3</b> Institucion disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomim.	
<b>Standardi IV.4 Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni u ofron këshillim karriere studentëve, ndjek progresin e tyre dhe i ndihmon ata në çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor; <b>Kriteri 2</b> Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.	Konstatohet se nëpërmjet Zyrës së Koordinimit dhe mbështetjes, institucioni është përgjegjës për krijimin e politikave mbështetëse që lidhen me zhvillimin e procesit mësimor. Gjithashtu, nëpërmjet zbatimit të programit të mentorshipit studentët realizojnë praktikën e tyre profesionale në shkollat e sistemit parauniversitar, cikli fillor.
<b>Konkluzionet e vlerësimit:</b> <b>Kriteret e pranimit të studentëve zhvillohen konform akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Në respektim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, AU, me vendim Senati, ka përcatuar kriteret e pranimit për këtë program studimi: 70% mesatarja e ponderuar sipas VKM në fuqi dhe 30% mesatarja e lëndëve që përcaktohen çdo fillim viti akademik për këtë program studimi.</b> <b>Koha e zgjatjes së studimeve është kryesisht 3 vite akademike. Nota mesatare në hyrje për vitin akademik 2018-20019 është 7.7. Numri i të regjistruarve për vitin akademik 2018-2019 është 16, ndër të cilët 14 të regjistruar për herë të parë dhe 2 transferim studimesh.</b> <b>Numri total i të punësuarve në përputhje me diplomën për programin e studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsim Fillor është i vogël 15, pasi pjesa më e madhe e të diplomuarve menjëherë pas përfundimit të ciklit të parë të studimeve ndjekin studimet e ciklit të dytë, për formimin e plotë akademik si mësues të ciklit fillor, sipas Ligjit të Arsimit të Lartë në fuqi.</b> <b>Dëshmojmë, gjithashtu, që institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve, për numrin e studentëve të regjistruar, për numrin e studentëve të transferuar, për tërheqjet dhe largimet para përfundimit të këtij program studimi.</b>	

### KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

#### 10. Kërkimi shkencor

##### Pjesa përshkimore

AU në politikat e tij ka si qëllim zhvillimin e kërkimit shkencor në funksion të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies dhe për rrjedhojë rritjen e cilësisë së programit të studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsim Fillor”. Stafi akademik i Departamentit të Edukimit dhe Anglishtes është angazhuar në kërkimin shkencor në disiplinat përkatëse të formimit duke marrë pjesë në Konferencat Kombëtare dhe Ndërkombëtare të organizuara nga institucioni dhe botime në revistën shkencore periodike “Optime” të institucionit. Gjatë periudhës 2017-2019, Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes ka pasur një aktivitet të pasur shkencor në nivel institucional dhe jo vetëm si dhe trajnime të vazhdueshme për kualifikimin e vazhdueshëm të stafit. Gjithashtu, ky departament ka organizuar aktivitete të ndryshme si Ekspozitë e Artit Figurativ, Vizitë në Albanian University, Konferenca Studentore, ku në qendër kanë qënë studentët e programit të studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsim Fillor”.



**Vlerësimi i Treguesve të Matshëm:**

**Të dhëna për kërkimin shkencor**

Numri i botimeve individuale të kërkimit shkencor nga stafi akademik i Departamentit të Edukimit dhe Anglishtes për periudhën 2017-2019, është 50. Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga IAL për këtë program studimi është 15, ku kanë marrë pjesë 7 anëtarë të personelit akademik të Departamentit të Edukimit dhe Anglishtes dhe studentë të programit të studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsim Fillor”. (Tabela 16 – Aneksë bashkëngjitur)

**Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion**

**11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar, si edhe marrëdhëniet me publikun**

**Pjesa përshkrimore**

Në politikat e tij për zhvillim dhe përmirësim, AU, ka prioritet marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet vendore, kombëtare, si edhe ato ndërkombëtare. AU ka nënshkruar marrëveshje institucionale me disa prej IAL publike si dhe Drejtoritë Arsimore Rajonale si dhe institucione të tjera për organizimin e konferencave, trajnimeve dhe zhvillimin e praktikës profesionale të studentëve të programit të studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsim Fillor”. Institucioni ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi dypalëshe edhe me institucione ndërkombëtare si Universitetin Sigmund Freud, Vjenë, Universitetin e Padovës, Aquilas, etj.

**Vlerësimi i Treguesve të Matshëm:**

**Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar.**

AU ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi dypalëshe edhe me institucione ndërkombëtare si Univeristetin Sigmund Freud, Vjenë, Universitetin e Pizes, Universitetin e Salernos, Universitetin e Padovës, Aquilas. Këto bashkëpunime janë realizuar në kuadër të programit Erasmus +, me qëllimin kryesor mobilitetin e stafit akademik dhe studentor. (Tabela 17 – Aneksë bashkëngjitur)

**Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë.**

Institucioni ka nënshkruar marrëveshje institucionale me disa Drejtori Arsimore Rajonale dhe Albanian College për zhvillimin e praktikës profesionale të studentëve që ndjekin këtë program studimi si edhe marrëveshje institucionale me disa prej IAL publike dhe institucione të tjera për organizimin e konferencave, leksioneve të hapura, trajnimeve, etj. (Tabela 17 – Aneksë bashkëngjitur)

**Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion**

Aktmarrëveshja e bashkëpunimit me Albanian College

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<b>VII - INSTITUCIONI GARANTON MARRËDHËNIE BASHKËPUNIMI, TË BRENDSHME DHE TË JASHTME</b> <b>Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të vet.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit; <b>Kriteri 2</b> Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.	Konstatohet që institucioni krijon klimë bashkëpunuese brenda institucionit për marrjen e përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre duke garantuar marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.
<b>Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve dëshmon se ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj; <b>Kriteri 2</b> Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofrojnë; <b>Kriteri 3</b> Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit; <b>Kriteri 4</b> Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	Konfirmohet që institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas dhe të huaj;  Konfirmohet që AU ka marrëdhënie bashkëpunimi me DAR për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës profesionale të studentëve të programit të studimit Bachelor në "Mësuesi për Arsim Fillor".  Konstatohet që institucioni organizon trajnime profesionale për stafin akademik dhe gjithashtu harton një raport analitik në të cilin analizohen edhe përfitimet nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.
<b>Konkluzionet e vlerësimit:</b>  Në politikat e tij për zhvillim dhe përmirësim, AU, ka prioritet marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet vendore, kombëtare dhe ndërkombëtare. AU ka nënshkruar marrëveshje institucionale me disa prej IAL publike si dhe Drejtoritë Arsimore Rajonale si dhe institucione për organizimin e konferencave të përbashkëta, trajnimeve. Institucioni ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi dypalëshe edhe me institucione ndërkombëtare si Universitetin Sigmund Freud, Vjenë, Universitetin e Padovës, Aquilas.  Konfirmohet që institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me DAR Tiranë për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale në këtë program studimi.	

**Mendojmë që institucioni duhet të angazohet më tepër për realizimin e bashkëpunimeve dypalëshe me institucionet ndërkombëtare, ku në fokus duhet të jetë pjesëmarrja në projekte dhe mobiliteti i pedagogëve dhe studentëve jo vetëm në rang institucional por edhe në rang departamenti.**

**Sugjerojmë, gjithashtu, të zgjerohet marrëveshja e bashkëpunimit me Albanian College, si institucion bazë pritës, mentorshipi, për realizimin e praktikave profesionale të studentëve të këtij program studimi.**

## ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Në datat 12 dhe 19 Qershor 2019, u përmbush vizita në institucion konform axhendës. Analiza e RVB, shqyrtimi i dokumentacionit ne dosjen e e vetevleresimit si dhe takimet dhe bashkebisedimet e qëllimita me grupet specifike duke perfshire stafin akademik, studentët, sekretarine si dhe përgjegjësi i departamentit, na rezulton se hartimi i RVJ përgjithësisht ka përputhje me RVB.

### **I. ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SWOT (STRENGTHS-PIKAT E FORTA, WEAKNESSES- PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES-MUNDËSITË, THREATS-PENGESAT).**

#### **a. Pika të forta:**

- 1) Zhvillimi i programit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor”, është orientuar në përputhje me strategjinë e institucionit, me vizionin, me misionin dhe me qëllimin e tij.
- 2) Funksionimi i plotë i sistemit të brëndshëm të cilësisë. UP “Albanian University” realizon një vlerësim periodik i cili është bërë pjesë e vazhdueshme e punës institucionale.
- 3) Cilësia e menaxhimit të PAE dhe PAK. UP “Albanian University” ka të ngritur një sistem funksional për këtë qëllim. Kështu ka politika dhe procedura transparente për rekrutimin e stafit, për vlerësimin e performancës së personelit, dhe për menaxhimin e të dhënave të personelit.
- 4) Respektimi i të drejtave. UP “Albanian University” ndjek një politikë ku respektohen të drejtat e individit, sidomos të studentëve. Kështu “AU” ju asiston studentëve për çështje mësimore, të praktikës, dhe u mundëson pjesmarrjen e rregullt në veprimtaritë e universitetit, ku studentët kanë dhe konferencën e tyre studentore.
- 5) Klima pozitive. UP “Albanian University” ndjek një politikë frytdhënëse për sigurimin e klimës së brendëshme pozitive psikologjike dhe emocionale të efektshme për mbarëvajtjen e marrëdhënieve si brenda institucionit ashtu dhe me aktorë të tjerë jashtë tij.
- 6) Programi Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor” ka në dispozicion të gjithë infrastrukturën e nevojshme, të tillë si auditorë, laboratorë, zyra, salla konferencash, bibliotekë, etj, për realizimin e procesit mësimor.
- 7) Institucioni ka politika të qarta dhe efektive për kualifikimin e vazhdueshëm të stafit, duke realizuar këtë në mënyrë periodike.
- 8) Institucioni është i prirur të përditësojë programin e studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsim Fillor” sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

#### **b. Pika të dobëta:**

- 1) Mungesa e granteve për kërkimin shkencor. UP “Albanian University” nuk ka një politikë të qartë për përthithjen e granteve për kërkimin shkencor.
- 2) Mungesa e një studimi të mirëorganizuar, me instrumentat e duhur për mbledhjen e të dhënave për njohjen e tregut të punës, sidomos tregut që ofrohet nga sistemi i shkollave jo-publike.

#### **c. Mundësitë:**

- 1) Krijimi i një sistemi elektronik për të dhënat të studentëve ku studentët të kenë mundësi për të aksesuar rekordet e tyre personale.
- 2) Kërkesat në rritje për mësues të ciklit fillor sidomos nga sistemi i jopublik.
- 3) Njohja dhe zbatimi i përvojave më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare. Në këtë kuadër UP “Albanian University” ka marrëveshje bashkëpunimi me disa institucione në rang kombëtar dhe gjithashtu ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi dypalëshe edhe me institucione ndërkombëtare si Universitetin Sigmund Freud, Vjenë, Universitetin e Padovës, Aquilas.
- 4) Zgjerimi i aktmarrëveshjes se bashkëpunimit me Albanian College, për realizimin e praktikave profesionale të studentëve të këtij program studimi
- 5) Hapja e ciklit të dytë të programit të studimit master profesional në “Mësuesi për Arsim Fillor”.

**d. Pengesat:**

- 1) Trendi në rënie i numrit të studentëve.
- 2) Intitucioni nuk ka tregues të matshëm për një parashikim të numrit të studentëve të cilët mund të regjistrohen për vitin akademik 2019-2020.

**Rekomandimet:**

- 1) Të realizohet një studim i detajuar i tregut të punës, i pajisur me metodologjinë dhe instrumentat e duhura për mbledhjen e të dhënave, për të hulumtuar në mënyrë më të plotë nevojat dhe mundësinë e punësimit të studentëve, për më tepër duke depistuar në mënyrë më të plotë kërkesat e punëdhënësve, sidomos atyre të sektorit jopublik
- 2) Të pasurohet fondi i titujve të bibliotekës në funksion të këtij programi studimi dhe të ngihen instrumentët matës për numrin e studentëve dhe lektorëve që frekuentojnë bibliotekën online “Questia”.
- 3) Të rishikohet plan programi i Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor” në masën 20 % duke u bazuar në “Standartet e formimit të përgjithshëm të mësuesit fillor” publikuar nga IZHA (2016) dhe në respektim të VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL”, për kategorizimin e saktë të veprimtarive formuese për programin bachelor.
- 4) Të mundësohet transferimi i sallës së leximit në një ambjent me dritë natyrale.

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm**

1. Dr. Dilina Beshiri

2. Dr. Leticja Gusho

## SUMMARY ANALYSIS FOR THE EVALUATION OF THE STUDY PROGRAM

### I. SUMMARY ANALYSIS OF THE RVJ BY SWOT METHOD (STRENGTHS, WEAKNESSES, OPPORTUNITIES, THREATS).

#### STRENGTHS

1. The orientation of the development of the Bachelor program in "Teacher for Elementary Education" is in line with the institution's strategy, vision, mission, and purpose.
2. The internal quality system is fully operational. PU "Albanian University" conducts a periodic assessment that has become an integral part of the institutional work.
3. Quality of FTS and PTS management. PU "Albanian University" has set up a functional system for this purpose. The policies and procedures for staff recruitment, staff performance assessment, and staff data management are clear.
4. Respect for human rights. PU "Albanian University" follows a policy where the rights of individuals, especially students, are respected. "AU" assists students on issues of learning, practice, and enables regular participation in university activities. Students also have their student conference.
5. The positive climate. UP "Albanian University" follows a viable policy for securing positive psychological and emotional climate, effective for the well-functioning of relations both within the institution and with other actors outside it.
6. The Bachelor Program in "Teacher for Elementary Education" has all the necessary infrastructure, such as auditors, laboratories, offices, conference rooms, libraries, etc. for the realization of the teaching and learning process.
7. The institution has a clear and effective policy of continuous staff training, doing this regularly.
8. The institution is prone to update the Bachelor study program "Teacher for Elementary Education" under the laws and bylaws in force.

#### WEAKNESSES

1. Lack of grants for research. PU "Albanian University" does not have a clear policy for absorbing scientific research grants.
2. Well-organized research, with appropriate instruments for collecting data for the labor market, especially the market provided by the non-public school system, is lacking.

#### OPPORTUNITIES:

1. Creating a student data system where students have the opportunity to access their records.
2. The growing demands for elementary school teachers, especially from the private school system.
3. The recognition and application of the best national and international practices. In this framework, PU "Albanian University" has a memorandum of understanding with several national institutions and has also signed a bilateral memorandum of understanding with international institutions such as Sigmund Freud University, Vienna, University of Padua, Aquila.
4. The expansion of the memorandum of understanding with Albanian College, for the realization of the internships of the students.
5. Opening of the master degree program in "Teacher for Elementary Education."

#### THREATS

1. The downward trend in the number of students.
2. The Institution has no measurable indicators for a prediction of the number of students who are going to enroll for the academic year 2019-2020.

#### Recommendation

- 1) To carry out a detailed labor market study, equipped with appropriate methodologies and data collection instruments, to explore in greater detail the needs and opportunities of student

employment, moreover by looking at the way employers' requirements, especially those of the private school sector.

- 2) Enrich library funding for this study program and include measuring instruments for the number of students and lecturers attending the Questia online library.
- 3) To review the Bachelor program "Teacher for Elementary Education" at 20% based on the "Standards of General Formation of Teacher for Elementary Education" published by IDE (2016) and concerning the DCM no. 41, date 24.1.2018 "On the elements of study programs offered by HEI," for the correct categorization of training activities for the bachelor program.
- 4) Transfer the reading room of the library in a space with natural light.

#### **External Evaluation Group**

1. Dr. Dilina Beshiri



2. Dr. Letija Gusho

